




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*



MODULI 3

Gjithëpërfshirja në Arsim

Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore



Fakulteti i Edukimit



IQA
INSTITUTI PËR KUALITETIN DHE ZHVILIMIN ARIMOR

MODULI 3

Gjithëpërfshirja në Arsim

Ngritja e Kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore

Falënderim

Ky material është zhvilluar dhe publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane.

Teksti origjinal në gjuhën Shqipe [2017] dhe i rishikuar [2020]

E drejta për përdorim, riprodhim dhe redaktim i është bartur Universitetit të Prishtinës - Fakultetit të Edukimit dhe Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit [2021]

Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo të Qeverisë Gjermane.

Autorë:

Carmen Matheis, Landesakademie Badiltdbad, Gjermani
M.Sc Selim Mehmeti

Rishikuar nga:

Marianne Müller RSD Freiburg, Germany
Dr. Naser Zabeli, Fakulteti i Edukimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"
Dr. Osman Buleshkaj, ekspert i arsimit

Koordinuar nga:

Lirie Lokaj, GIZ

Dizajni dhe faqosja nga:

Envinion, Prishtinë



Implemented by

giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbajtja

Akronimet dhe Shkurtesat	6
1. Hyrje	8
2. Qëllimi i Modullit.....	10
3. Pasqyra e gjendjes së arsimit të fëmijëve të marginalizuar dhe të cenuar...12	
4. Çka është Arsimi Gjithëpërfshirës?	14
5. Arsimi Gjithëpërfshirës në Kosovë.....	16
5.1 Korniza e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë.....	17
5.2 Sistemet mbështetëse për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë.....	18
6. Shkollat gjithëpërfshirëse	20
6.1 Mjedisi shkollor	22
6.1.1 Vlerat, besimet dhe pritjet.....	22
6.1.2. Masat e mësimdhënies dhe mësimnxënies.....	24
6.2 Profilet e mësimdhënësit në funksion të arsimit gjithëpërfshirës.....	25
6.2.1. Mësimdhënësi gjithëpërfshirës	26
6.3 Shërbimet mbështetëse	27
6.3.1. Profili i mësimdhënësit mbështetës.....	29
6.3.2. Profili i edukatorit/es mbështetës.....	29
6.3.3. Profili i mësimdhënësit udhëtues.....	30
6.3.4. Profili i asistentit	31
7. Të mësuarit së bashku	32
7.1. Klasat gjithëpërfshirëse.....	32
7.1.1. Shtatë vëzhgime të shpejta për të konfirmuar një klasë gjithëpërfshirëse.....	33
7.1.2. Klasat e dekoruara dhe të organizuara	34
7.1.3. Takimet në klasë	34
7.1.4. Klasat respektuese.....	35
7.1.5. Mjediset më së paku kufizuese	35
7.2. Udhëheqja e shkollës.....	36
8. Indeksi i gjithëpërfshirjes.....	38
9. Regjistrimi dhe barazia në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë....41	
9.1. Arsimitimi i nxënësve nga komunitetet pakicë.....	42
9.2. Parandalimi i braktisjes së shkollës dhe mosvijimit në shkollë	43
9.3. Promovimi i barazisë gjinore në arsim.....	45

10. Qasjet e ndryshme drejt arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta	48
10.1 Trajnimi dhe zhvillimi i mësimeve para hyrjes në shërbim dhe gjatë shërbimit.....	49
10.1.1. Nevojiten trajnimet e mësimeve.....	51
11. Sfidat për diversitet dhe gjithëpërfshirje në shkollat e Kosovës	52
11.1. Si të arrihet progresi në gjithëpërfshirje në shkollat e Kosovës?.....	55
12. Përmbllja e Modullit.....	59
Fjalorthi.....	59
Burimet dhe referencat.....	61
Shtojca 1	63

Akronimet dhe Shkurtesat

ShMP	Shkollat Miqësore për Fëmijët
KDF	(CRC) Konventa për të Drejtat e Fëmijës
CRPD	Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
EpGj	Edukimi për të Gjithë
FSDDED	Mbështetja Finlandeze për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë
GPCWD	Partneriteti Global për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara
GPE	Partneriteti Global për Arsim
HRBA	Qasja e Bazuar në të Drejtat e Njeriut
AGj	Arsimi Gjithëpërfshirës
PIA	Plani Individual i Arsimit
GAGj	Grupi i Arsimit Gjithëpërfshirës
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
OBEZh	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
OHCHR	Zyra e Komisionarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
UNICEF	Fondi Emergjent i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

MODULI I TRETË ADRESON DISA ASPEKTE TË STANDARDEVE TË PRAKTIKËS PROFESIONALE TË DREJTORËVE TË SHKOLLAVE.

NË MËNYRË TË DREJTËPËRDREJTË KY MODUL ADRESON STANDARDET 1, 2 DHE 6 PËRMES TEMAVE NË VIJIM:

Standardi 1:
Udhëheqja dhe
motivimi

→ Politikat dhe udhëheqja për arsim gjithëpërfshirës në Kosovë

Standardi 2:
Mësimdhënia dhe
nxënia cilësore

→ Mjedisi shkollor dhe të mësuarit së bashku;

→ Qasjet e ndryshme në punë me fëmijët me nevoja të veçanta;

Standardi 6:
Etika profesionale

→ Shkolla gjithëpërfshirëse;

→ Barazia, diversiteti dhe gjithëpërfshirja;

1. Hyrje

Programi Zhvillimi i Kapaciteteve në Sektorin e Arsimit Fillor në Kosovë (CDBE) ndër aktivitetet e tjera synon të kontribuojë në menaxhimin dhe udhëheqjen efikase dhe të orientuar drejt cilësisë të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta.

Në këtë kontekst, përmirësimi i menaxhimit dhe qeverisjes së shkollave kuptohet si detyrë që përfshin drejtorët e shkollave (dhe ekipet e tyre menaxhuese/Këshillat Drejtues të shkollave, koordinatorët e cilësisë, aktivat profesionale) si dhe stafin e DKA-ve; programi synon forcimin e shkollave dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre për t'u përballur me këto sfida të reja.

Me procesin e decentralizimit dhe autonominë më të madhe të shkollës, roli dhe funksioni i drejtorëve të shkollave ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. Ata janë të rëndësishëm kryesorë jo vetëm për menaxhimin e përditshëm të shkollës, por edhe për sigurimin e zhvillimit të ardhshëm dhe rritjen e cilësisë së arsimit në shkollë.

Me rishikimin e programit të trajnimit ekzistues të menaxhimit të arsimit, synohet rritja e mëtejshme e kapaciteteve menaxhuese për drejtorët e shkollave, stafin e DKA-ve dhe rritja e numrit të kandidatëve të trajnuar për pozitën e drejtorëve të shkollave dhe menaxherëve të institucioneve të tjera arsimore

Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit (IHZHA) në kuadër të Fakulteti i Edukimit, me mbështetjen e GIZ-CDBE kanë rishikuar programin bazuar në programet e trajnimit menaxhues të orientuar drejt kërkesës (trajnime në shërbim si për drejtorët e shkollave ashtu edhe për Drejtoritë Komunale të Arsimit).

Objektivi i përgjithshëm i programit të trajnimit është të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e menaxhimit të shkollës, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e arsimit për të gjithë. Për këtë qëllim, aspektet relevante janë identifikuar dhe përpunuar në bazë të vlerësimit të trajnimeve. Programi përbëhet nga 7 module, secili prej tyre shërben për një qëllim të caktuar dhe përcakton rezultatet e pritura.

Sipas Raportit Botëror mbi Aftësinë e Kufizuar¹, më shumë se një miliard njerëz vlerësohet se jetojnë me një formë të aftësisë së kufizuar, ose rreth 15% e popullsisë botërore, ku së paku 1 në 10 është fëmijë, dhe 80% jetojnë në vendet në zhvillim dhe përfaqësohen në mënyrë joproporcionale në mesin e të varfërve. Në mesin e grupeve të marginalizuara, fëmijët me aftësi të kufizuara mbeten më të përjashtuar, të diskriminuar jo vetëm për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar, por edhe për shkak të mungesës së të kuptuarit dhe njohurive rreth shkaqeve, implikimeve dhe stigmave të saj.

Korniza strategjike "Arsimi dhe Trajnimi 2020" (AT 2020) e Komisionit Evropian² ofron objektiva strategjike për bashkëpunimin evropian në arsim dhe trajnim. Një nga objektivat e AT 2020 është

¹ OBSSH dhe Banka Botërore (2011). Raporti botëror për aftësinë e kufizuar. Shih listën e referencave.

² Komisioni Evropian. Arsimi dhe trajnimi për gjithëpërfshirjen sociale.

promovimi i barazisë, kohezionit social dhe qytetarisë aktive. Politika e arsimit dhe trajnimit duhet të mundësojë që të gjithë qytetarët, pavarësisht rrethanave të tyre personale, sociale apo ekonomike, të fitojnë dhe zhvillojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për punësimin e tyre dhe të nxisin të mësuarit e mëtejshëm, qytetarinë aktive dhe dialogun ndërkulturor. Sistemet e arsimit dhe trajnimit duhet të synojnë të sigurojnë që të gjithë nxënësit - duke përfshirë ata me kushte jo të favorshme, ata me nevoja të veçanta dhe emigrantë të përfundojnë arsimimin e tyre dhe në mënyrë që të trajtohen pabarazitë, nevojiten sistemet e arsimit më efikas, por në të njëjtën kohë më gjithëpërfshirës dhe më të barabartë, të cilat ofrojnë qasje në ofrimin e arsimit cilësor. (Komisioni Evropian).

Gjatë dy dekadave të fundit, konteksti i arsimimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore ka ndryshuar dukshëm. Kjo ka ndodhur si rezultat i lëvizjes dhe zotimit ndërkombëtar për të siguruar që çdo fëmijë dhe i rritur të ketë arsimim fillor të cilësisë së mirë. Në fakt, një nga trendet aktuale në arsim në shkollat publike është lëvizja drejt përfshirjes së plotë të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe aftësi të kufizuara në shkollat e rregullta. Gjithëpërfshirja bazohet në konceptin e drejtësisë sociale, ku të gjithë nxënësit kanë të drejtën e qasjes së barabartë në të gjitha mundësitë arsimore, pa marrë parasysh nevojat ose ndonjë formë tjetër të gjendjes së disfavorshme. Arsimi gjithëpërfshirës përfshin qasjet e të nxënësve me nxënësin (e jo me kurrikulën) në qendër të vëmendjes.

Ky trend është mbështetur nga politikat e Kombeve të Bashkuara që afirmojnë të drejtat e fëmijëve dhe Edukimin për të Gjithë përmes konventave të tilla si: Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,³ dhe Deklarata e Salamankës e UNESCO-s⁴. Qëllimi i këtyre dokumenteve qartazi shpreh synimin e garantimit të arsimit cilësor për të gjithë fëmijët pavarësisht dallimeve të tyre individuale ose të të nxënësve, dhe thekson rëndësinë e ofrimit të mundësive të njëjta për të gjithë fëmijët për të arritur potencialin e tyre zhvillimor, dhe për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote në institucionet e arsimore dhe mjediset e komunitetit.

Arsimi gjithëpërfshirës si një qasje arsimore është relativisht e re në Kosovë. Në të vërtetë, që nga viti 1999, reforma të shumta që u zhvilluan në të gjitha nivelet e arsimit çuan në koncepte të reja në aspektin e trajtimit dhe vendin që arsimi gjithëpërfshirës duhet t'a ketë në kontekstin e sistemit arsimor. Që atëherë janë bërë hapa të rëndësishëm drejt krijimit të infrastrukturës ligjore, e cila do të mundësojë arsimimin e të gjithë fëmijëve dhe do të sigurojë një ambient të hapur ndaj ndryshimeve. Në këtë drejtim, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka përfshirë arsimin gjithëpërfshirës si një filozofi, e cila përshkon të gjitha politikat e saj, nga legjislacioni tek dokumentet e tjera shoqërore që promovojnë arsimin gjithëpërfshirës.

3 Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 28 dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 24

4 UNESCO 1994. Deklarata e Salamankës dhe korniza për veprim për arsimin me nevoja të veçanta. www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.PDF

2. Qëllimi i Modullit

Ky Modul synon të zhvillojë praktika gjithëpërfshirëse të arsimit në shkolla në mënyrë që të mbështes përfshirjen e një game të gjerë të preferencave dhe nevojave mësimore që gjenden në klasat e sotme.

Çka mbulon ky Modul?

Ky modul ofron informata se si të përmirësohet qasja arsimore dhe cilësia për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Ofron një pasqyrë të gjendjes së arsimimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe ofron informata bazë për të kuptuar konceptet kyçe të arsimit gjithëpërfshirës, me theks në krijimin e kushteve thelbësore që i përgjigjen nevojave të secilit fëmijë, duke përfshirë ata me aftësi të kufizuara.

Udhëzimet janë të ndara në katër kapituj.

Kapitulli i parë: prezanton përkufizimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe shkollës gjithëpërfshirëse.

Kapitulli i dytë: ofron informata dhe shembuj të veprimeve që mund të ndërmerren për të lëvizur sistemet drejt gjithëpërfshirjes më të madhe. Ai fokusohet në të drejtat e fëmijëve dhe mjedisin shkollor duke eksploruar fjalë kyçe si: vlerat, bindjet dhe pritjet e shkollës, masat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, praktikat e mësimdhënies, të mësuarit bashkëpunues, mjediset më së paku kufizuese, udhëheqja e shkollës e cila siguron që të gjithë fëmijët të përfitojnë, me theks tek fëmijët me nevoja të veçanta arsimore.

Kapitulli i tretë: ofron një pasqyrë të shkurtër historike për të drejtën e arsimit, zotimet ndërkom-bëtare për realizimin e saj dhe aspektet kyçe në zhvillimin e kornizës gjithëpërfshirëse, siç janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe Deklarata e Salamankës e UNESCO-s.

Kapitulli i katërt: paraqet qasje të ndryshme për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, siç janë: ndarja (veçimi); integrimi; gjithëpërfshirja.

Nëpërmjet këtyre kapitujve kemi për synim të shtjellojmë dhe paraqesim disa prej praktikave më të mira, problemeve dhe sfidave në bërjen e arsimit gjithëpërfshirës realitet.



3. Pasqyrë e gjendjes së arsimimit të fëmijëve të marginalizuar dhe të cenuar

Fëmijët me nevoja të veçanta kanë të drejtën e arsimimit pa diskriminim dhe në bazë të barazisë së mundësive¹. Megjithatë, në nivel global janë 50-75 milionë fëmijë ‘të marginalizuar’ të cilët nuk janë të regjistruar në shkollë⁵.

Faktet tregojnë:

- ➔ Në Kosovë nuk ka të dhëna të sakta lidhur me numrin e personave me nevoja të veçanta dhe llojin e vështirësive që kanë. Sidoqoftë, “më shumë se një miliard njerëz vlerësohet të jetojnë me një formë të vështirësisë ose rreth 15% e popullsisë së botës (bazuar në vlerësimet globale të popullsisë të vitit 2010). Kjo është më lartë se vlerësimet e mëparshme të WHO-s, të cilat datojnë nga vitet e 70-ta dhe kanë ofrojnë një shifër prej 10%”.
- ➔ Pra, në Kosovë ekzistojnë rreth 150,000 njerëz me nevoja të veçanta të theksuara që vuajnë nga përjashtimi i përhapur në jetën e tyre të përditshme, qoftë në qasje në kujdesin shëndetësor, të drejtën për arsimim të barabartë, mundësi të barabarta punësimi ose pjesëmarrje në jetën politike dhe publike.
- ➔ Një e treta e të gjithë fëmijëve që nuk janë të regjistruar në shkollë kanë vështirësi të natyrave të ndryshme dhe vetëm 5% e të gjithë fëmijëve me dëmtime të natyrave të ndryshme në mbarë botën kanë përfunduar shkollën fillore⁴. Kjo do të thotë që fëmijët me nevoja të veçanta kanë më pak gjasa të shkojnë në shkollë sesa fëmijët e tjerë. Vetëm 33.4% e fëmijëve me nevoja të veçanta si pasojë e dëmtimeve të ndryshme janë regjistruar në arsimin parauniversitar në vitin 2011-2012 në Kosovë (MASH 2014).
- ➔ Sipas Anketës së Grupeve të Treguesve të Shumëfishtë (2014)⁵ fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë hyjnë në shkollë më vonë se moshatarët e tyre (shkalla e pranimit neto në shkollë fillore është 68.1%), shkalla e tyre e ndjekjes së shkollës fillore neto është 85.3%, duke qenë në rënie të konsiderueshme në shkollën e mesme të ulët (65% shkalla neto e vijueshmërisë në shkollë) dhe në shkollën e mesme të lartë (30.3%).
- ➔ Sipas Profilit Gjiner të Shtetit paraqitet se njerëzit me nevoja të veçanta në Kosovë (duke përfshirë dëmtimet fizike, prapambetjen mendore, persona të verbër dhe të shurdhër) përballen me diskriminim. Institucionet kanë zbatuar në mënyrë të pamjaftueshme ligjet që sigurojnë qasje në arsim, shërbime sociale dhe shërbime të tjera. Vajzat, fëmijët nga pakicat dhe ata nga zonat rurale si dhe fëmijët me nevoja të veçanta mbeten të përjashtuar gjerësisht nga qasja në arsimin e fëmijërisë së hershme.
- ➔ Njerëzit me nevoja të veçanta që ndjekin shkollën kanë më shumë gjasa të jenë të arsimuar në mjedise të specializuara që mund të thellojnë marginalizimin e tyre⁵.
- ➔ Fëmijët me nevoja të veçanta kanë mbetur relativisht të padukshëm në përpjekjet për arritjen e qasjes universale në arsimin fillor ashtu siç kërkohet në Objektivat e Edukimit për të Gjithë (EpGj).
- ➔ Njerëzit e prekur nga vështirësi të ndryshme kanë më shumë gjasa të përjetojnë varfërinë, dhe të qenit i varfër e rrit mundësinë për të pasur ndonjë vështirësi të theksuar.


⁵ UNICEF 2014. Studimi i Grupit të Treguesve të Shumëfishtë.

DETYRË INDIVIDUALE:

Shkruani një fletë të fakteve të fëmijëve të marginalizuar dhe të cenuar në shkollën tuaj. Ndani me grupin tuaj. Sa të ndryshme/të ngjashme janë shkollat tuaja?

Diskutimi në grup: Si t'i përmirësojmë më mirë shkollat tona?

Shikoni diagramin dhe diskutoni në grupe. Cilat aspekte të përmirësimit të shkollës janë të lehta për t'u arritur? Cilat janë më të vështira dhe pse?



4. Çka është Arsimi Gjithëpërfshirës?

Në këtë kapitull do të diskutojmë se si përkufizohet gjithëpërfshirja dhe cilat hapa praktike kërkohen për ta bërë gjithëpërfshirjen në arsim realitet.

AKTIVITETI 2

Diskutoni në grup dhe përpuni të përgjigjeni në pyetjen: Ç'është arsimi gjithëpërfshirës? Pas diskutimit, prezentoni përkufizimet.

Arsimi gjithëpërfshirës është një koncept dinamik që vazhdimisht evoluon për të reaguar dhe mbështetur përfshirjen e gamës së gjerë të preferencave dhe nevojave të mësimi që gjenden në klasat e sotme. Ndërsa fillimisht fokusohej në gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta, arsimi gjithëpërfshirës është një koncept i gjerë që mbulon të gjitha grupet e fëmijëve, duke përfshirë ata që mund të jenë të marginalizuar dhe të cenueshëm, nga kultura të ndryshme ose grupe të ndryshme etnike, në varfëri ose për çfarëdo arsye tjetër nga qasja në shkollë të rregullt ose mund të jetë në rrezik të përjashtimit (mospërfshirjes) nga arsimi.

UNESCO e përkufizon arsimin gjithëpërfshirës si *“proces të adresimit dhe reagimit ndaj diversitetit të nevojave të të gjithë nxënësve përmes rritjes së pjesëmarrjes në procesin e të nxënësve, kultura dhe komunitete dhe zvogëlimit të përjashtimit në kuadër të arsimit dhe nga arsimi. Ai përfshin ndryshime dhe modifikime në përmbajtje, qasje, struktura dhe strategji, me një vizion të përbashkët që mbulon të gjithë fëmijët e grup moshës së duhur, dhe me një bindje se është përgjegjësi e shtetit që t'i arsimojë të gjithë fëmijët”*.

Në veçanti, elementet kyçe në vijim kanë tendencë të paraqiten fuqishëm në konceptimin e gjithëpërfshirjes:

1. Është qasja e bazuar në të drejta dhe ndjek modelin social.
2. Pranon se të gjithë fëmijët mund të mësojnë.
3. Pranon dhe respekton dallimet tek fëmijët: mosha, gjinia, përkatësia etnike, gjuha, gjendja shëndetësore, gjendja ekonomike, dëmtimet e llojeve të ndryshme, gjendja e HIV/TB, stili i jetës dhe format e tjera të dallimeve.
4. Pranon që mësimi fillon në lindje dhe vazhdon gjatë gjithë jetës dhe përfshin mësimin në shtëpi dhe në komunitet dhe në situata formale, informale dhe jo formale.
5. Bëhet fjalë për ndryshimin e sistemit për t'iu përshtatur nxënësit, e jo për ndryshimin e nxënësit për t'iu përshtatur sistemit, sepse problemit i përjashtimit është thellë i vendosur brenda sistemit, e jo brenda personit ose tipareve të tij.
6. Është një proces dinamik i cili vazhdimisht po evoluon sipas kulturës dhe kontekstit.
7. Është një strategji e gjerë për promovimin e shoqërisë gjithëpërfshirëse.

6 UNESCO (2005) Udhëzimet për gjithëpërfshirje: sigurimi i qasjes së arsimit për të gjithë, Paris.

7 Stubbs, S (2008) Arsimi gjithëpërfshirës: Ku ka burime të pakta, Oslo: The Atlas Alliance, p.8.

Sipas UNESCO-s (2009), gjithëpërfshirja në arsim mund të shihet si një aspekt i gjithëpërfshirjes në shoqëri. Është process i: (a) trajtimit dhe reagimit ndaj diversitetit të nevojave të të gjithë fëmi jëve, të rinjve dhe të rriturve nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në të nxënit, kultura dhe komunitete dhe zvogëlimit dhe eliminimit të përjashtimit brenda arsimit dhe nga arsimit; (b) forcimi i kapacitetit të sistemit arsimor për t'u shtrirë tek të gjithë nxënësit pavarësisht nga varfëria, gjinia, përkatësia etnike, gjuha, dhe dëmtimet.

Prandaj, arsimi gjithëpërfshirës është një qasje që kontribuon në promovimin e një mjedisi social dhe gjithëpërfshirës, ku të gjithë fëmijët dhe të rriturit marrin pjesë dhe kontribuojnë në shoqëri, pavarësisht gjinisë, moshës, aftësive, përkatësisë etnike, dëmtimit ose gjendjes shëndetësore. Dallimet respektohen dhe vlerësohen. Diskriminimi dhe paragjykimet janë të ndaluara në mënyrë aktive nga politikat dhe institucionet.

Arsimi është një e drejtë thelbësore e të gjithë fëmijëve dhe qëllimi i arsimit gjithëpërfshirës është të sigurojë që të gjithë fëmijët të kenë qasje në arsimim adekuat, në dispozicion dhe efektiv brendakomuniteteve të tyre. Ky arsimim fillon në shtëpi brenda familjes dhe përfshin iniciativa formale ose joformale; ndërkohë që vazhdon me të gjitha llojet e institucioneve arsimore të bazuara në komunitet.

Për më tepër, arsimi gjithëpërfshirës nuk merret vetëm me përgatitjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, por gjithashtu synon ndryshime thelbësore në mënyrën se si e perceptojmë diversitetin në klasë dhe në të gjithë shoqërinë.

Arsimi gjithëpërfshirës kërkon rindërtimin e kulturave, strukturave, praktikave dhe metodologjive të përdorura në shkolla. Shkolla gjithëpërfshirëse duhet të ofrojë raste dhe mundësi për një sërë metodash pune dhe trajtim individual, për të siguruar që asnjë fëmijë të mos përjashtohet nga pjesëmarrja në shkollë. Kjo nënkupton zhvillimin e shkollave me bazë në të drejta dhe miqësore për fëmijët, të cilat jo vetëm që janë efektive në aspektin akademik, por edhe janë gjithëpërfshirëse, të shëndetshme dhe mbrojtëse të të gjithë fëmijëve, u përgjigjen aspektit gjinor dhe inkurajojnë pjesëmarrjen e vetë nxënësve dhe të familjeve e komuniteteve të tyre (UNESCO 2009).

Gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta është kryesisht e lidhur me të drejtat themelore të njeriut, respektivisht me të drejtën e fëmijëve për t'u arsimuar me moshat e tyre. Për të arritur këtë të drejtë, sistemi arsimor dhe shkollat duhet të ndryshojnë dhe të jenë sa më të adaptueshme që të jetë e mundur. Sistemi arsimor duhet t'i përshtatet fëmijës. Për shembull, do të ishte shumë e vështirë të përfshini një fëmijë me dëmtime të rënda – prapambetje mendore në arsimin e rregullt, duke pasur parasysh se ai nuk do të ishte në gjendje të përparonte në nivelin e moshatarëve të tij, dhe nuk do të ishte në gjendje të arrijë sukses përmes programit të rregullt mësimor. Është e mundur që fëmija të përfshihet në procesin ku rezultatet e të nxënit përshtaten me nevojat e tij. Kjo do të kërkonte një program fleksibil të mësimdhënies për individualizimin e arritjeve.

Arsimi gjithëpërfshirës fokusohet në identifikimin dhe largimin e pengesave në të nxënë (përvetësimin e njohurive) dhe pjesëmarrjen. Në vend që të bëhen përpjekje për t'i bërë personat “normal”, duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje përpjekjeve për të krijuar një mjedis “normal” për ta.

Idetë thelbësore të arsimit gjithëpërfshirës mund të gjenden në shumë dokumente të mëparshme politike përfshirë: “Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (1989)”, “Deklarata Botërore për

Edukimin për të Gjithë” (Tajlandë, 1990). Rregullat Standarde për Barazimin e Mundësive për Personat me Aftësi të Kufizuara “(1993), ” Deklarata e Salamankës dhe Kuadri i Veprimit për Arsimimin e Nevojave të Veçanta të miratuar nga Konferenca Botërore mbi Arsimin e Nevojave të Veçanta (Spanja, 1994).

5. Arsimi Gjithëpërfshirës në Kosovë

Politika e arsimit gjithëpërfshirës u prezantua brenda kornizës legjislative në formën e Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës. ‘Gjithëpërfshirja’ si koncept përshkon tërë ligjin, i cili bazohet në Deklaratën e Salamankës mbi Gjithëpërfshirjen dhe Konventën për të Drejtat e Njeriut. Sipas ligjit, të gjitha shkollat janë të detyruara të ofrojnë sigurinë e fëmijëve, duke ndaluar ndëshkimin fizik dhe poshtërimin e nxënësve nga shkolla, dhe të vendosin të drejtën që secili fëmijë të edukohet në gjuhën e grupit të tij etnik. Ligji në mënyrë specifike u jep çdo fëmijë të drejtën për arsimim dhe vendos përgjegjësinë mbi MASH-in për të siguruar ofrimin e arsimit.

Qëllimi i ligjvënësit është të sigurojë që secili fëmijë të jetë i caktuar në shkollë në zonën e tij të banimit. Fëmija mund të zhvendoset në një shkollë tjetër nëse konsiderohet se është në interesin më të mirë të fëmijës. Një komision ekspertësh do ta përcaktojë këtë, sipas kërkesës së shkollës ose prindërve.

Përveç Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, progresi drejt zhvillimit dhe përmirësimit të legjislacionit të orientuar drejt gjithëpërfshirjes nga MASH-i, rezultojnë me një sërë dokumentesh si: Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë (PSAK) 2017-2021, Plani Strategjik për Arsimin Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020, Korniza e Kurrikulës së Kosovës, Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë 2009-2015, etj.

Përkundër progresit në disa fusha, ende ekzistojnë shumë sfida lidhur me zbatimin e parimeve të gjithëpërfshirjes. Megjithatë nuk ka të dhëna të sakta në lidhje me gjithëpërfshirjen e fëmijëve nga grupet e cenuara (kryesisht fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët nga migracioni dhe varfëria e skajshme), ka disa raporte që tregojnë se numri i fëmijëve të regjistruar në shkolla nga këto grupe është shumë i ulët. Vetëm 33.4% e fëmijëve me aftësi të kufizuara u regjistruan në arsimin parauniversitar në Kosovë në vitin 2011-2012, megjithatë trendi ka pasur një rritje të lehtë në vitet e fundit (MASH 2014). Sipas Studimit të Grupit të Treguesve të Shumëfishtë (2014), fëmijët e komuniteteve RAE hyjnë në shkollë më vonë se moshatarët e tyre. Nga ana tjetër, mungesa e trajnimeve profesionale, mungesa e infrastrukturës adekuate në shkolla, mungesa e zbatimit të infrastrukturës ligjore, niveli i paragjykimeve dhe mungesa e personelit ndihmës në shkollë ndikon që ende të kemi shkollë të lartë të fëmijëve që janë jashtë arsimit të detyrueshëm.

5.1 Korniza e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë

Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës 2011 - “Gjithëpërfshirja” si koncept përfshihet në tërë ligjin, i cili bazohet në Deklaratën e Salamankës për Gjithëpërfshirje dhe Konventën për të Drejtat e Njeriut.

Korniza e Kurrikulës së Kosovës (KKK) (2016) - Një nga parimet kryesore mbi të cilat është zhvilluar KKK-ja është gjithëpërfshirja. KKK-ja është në përputhje me Edukimin për të Gjithë dhe Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Standardet e zhvillimit dhe mësimnxënies në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç (2011), është një dokument tjetër i rëndësishëm që ofron një qasje gjithëpërfshirëse për arsimin e hershëm me fëmijët në qendër të vëmendjes dhe arritjet e tyre në periudha të caktuara të moshës në fusha të ndryshme të zhvillimit.

Standardet për shkollat miqësore për fëmijët 2012, të cilat bazohen në Konventën për të Drejtat e Fëmijës, paraqesin një qasje gjithëpërfshirëse që lidh aspektet e reformës arsimore dhe që i vendos fëmijët në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet e organizuara dhe zbatuara në shkollë.

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 (PSAK) është një plan pesëvjeçar që lidh mësimin gjatë gjithë jetës me gjithëpërfshirjen në arsim dhe një model për të arritur tek të gjithë nxënësit dhe që ofron mundësi të barabarta për arsim cilësor për të gjithë. Në këtë plan strategjik, arsimimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore i referohet Planit Strategjik për përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin parauniversitar 2010-2015, dokument i cili është hartuar në vitin 2010. Në kuadër të ndërtimit të kapaciteteve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës, 9 edukatorë mbështetës janë punësuar për nivelin parashkollor, dhe 28 mësimdhënës mbështetës për shkollat e rregullta.

Plani Individual i Arsimit (PIA) (2013) është një dokument zyrtar pedagogjik i hartuar për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, për të cilët ekipi vlerësues i ekspertëve të fushave të ndryshme të zhvillimit kanë vendosur të ofrojnë arsim të përshtatshëm për fëmijët me nevoja të veçanta.

Miratimi i Udhëzimeve “Indeksi për gjithëpërfshirje” dhe pilotimi në 8 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe në 8 institucione parashkollore në 8 komuna, ishte gjithashtu një veprim tjetër që ka ndihmuar institucionet parashkollore dhe shkollat në krijimin e një mjedisi më gjithëpërfshirës.

“Mësimdhënia në bazë të fushave të veprimtarisë”, i hartuar nga MASH-i është një tjetër dokument i rëndësishëm, program ky i cili i dedikohet nxënësve me shkallë të rëndë të dëmtimeve që nuk mund të ndjekin programin e rregullt mësimor.

Krijimi i ekupeve të vlerësimit pedagogjik dhe pajisja e tyre me udhëzimet dhe instrumentet të cilat janë të dizajnuara për ekipet profesionale të vlerësimit në komuna, me të cilat instrumente ata i vlerësojnë /nxënësit me nevoja të veçanta.

Një kontribut i vlefshëm drejt arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë është dhënë nga disa agjenci ndërkombëtare si: Mbështetja Finandeze për Zhvillimin e Arsimit në Kosovë (FSDEK), Save the Children, UNICEF, Handikos, etj.

Korniza ligjore për zhvillimin e sistemit të arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë e përcaktuar në dokumentet ligjore dhe nënljore të nxjerra nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), përfshin por nuk kufizohet vetëm në:

- 1 Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës; dhe disa udhëzime administrative lidhur me Ligjin dhe në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës dhe nevojat e veçanta;
- 2 Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK 2017-2021) dhe si pjesë e tij Planin Strategjik për Organizimin e Arsimit Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Arsimin Parauniversitar në Kosovë (2010-2015);
- 3 Kornizën e Kurrikulës së Kosovës (2016); Ligjin nr. 05/L -020 për Barazinë Gjinore;
- 4 Ligjin nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë.
- 5 Ligjin nr. 02/L-52 për Arsimin Parashkollor (2006)
- 6 Planin strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë (2010 – 2015)
- 7 Planin Kombëtar të Veprimit për Aftësinë e Kufizuar në Republikën e Kosovës 2009-2011
- 8 Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Kosovë, Komponenti i Arsimit 2007 – 2017
- 9 Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, 2009 – 2015; Standartet për shkollat miqësore për fëmijët (2012)

5.2 Sistemet mbështetëse për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës në Kosovë

Për të krijuar një sistem arsimor gjithëpërfshirës, fokusi kryesor duhet të jetë në atë që po ndodh në klasat e rregullta dhe si të mbështesin mësimdhënësit e rregullt gjithëpërfshirjen dhe përmbushjen e nevojave të ndryshme në klasë. Në këtë program trajnimi, gjithëpërfshirja paraqitet përmes praktikave të regjistrimit në shkollat e Kosovës, përmes strukturës dhe funksionimit të shërbimeve mbështetëse për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në Kosovë, pasqyrës së veprimeve për të ofruar arsim cilësor për nxënësit nga komunitetet pakicë, veprimeve për të parandaluar braktisjen dhe për të gjetur fëmijët e mosinkuadruar në shkollë, se si barazia gjinore është e inkuadruar në sistemin arsimor dhe se si sistemi aktual i trajnimit të mësimdhënësve po përballet me nevojat e mësimdhënësve në klasat dhe shkollat gjithëpërfshirëse.

Sipas Deklaratës së Salamankës dhe Kornizës për Veprim në Arsimin me Nevoja të Veçanta (1994), përkthimi i vizionit të arsimit gjithëpërfshirës në praktikë kërkon krijimin e politikave arsimore, praktikave pedagogjike dhe mjediseve mësimore që përfshijnë të gjithë fëmijët. Gjithëpërfshirja shkon përpara paralelisht me aftësinë për të ofruar shërbime mbështetëse për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore (NVA) në shkollat e tyre të rregullta në lagje.

Gjatë 15 viteve të fundit, me mbështetjen e shumë donatorëve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka qenë duke zhvilluar një sistem për të siguruar qasje dhe mbështetje për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Shumë zhvillime pozitive janë arritur duke filluar nga legjislacioni dhe krijimi i shërbimeve dhe mekanizmit për të ofruar mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore.

Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar, fëmija ka vështirësi në të nxënë nëse fëmija ka vështirësi shumë më të madhe në mësim se shumica e fëmijëve të asaj moshë; ose në qoftë se fëmija ka ndonjë vështirësi që ose e parandalon ose e pengon atë që të përdorë objektet arsimore të një lloji të parashikuar në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij në institucionet arsimore dhe/ose të trajnimit.

Në MASH, Divizioni i Arsimit me Nevoja të Veçanta (DANV) vepron në kuadër të Departamentit të Politikave të Arsimit Parauniversitar (DPAP), dhe përbëhet nga katër ekspertë dhe një administrator.

AKTIVITETI 3 SI TË PËRMIRËSOHET GJENDJA AKTUALE?

1. Cila është gjendja aktuale në shkollën tuaj në lidhje me gjithëpërfshirjen?
2. Çfarë aktiviteteve specifike është duke i ndërmarrë shkolla e juaj? Si?
3. Çfarë mbështetje keni nga zyra e DKA-së? Si do ta përmirësonit këtë?
4. Çfarë mbështetje keni nga MASHT-i? Si do ta përmirësonit këtë?
5. Shpjegoni mbështetje të tjera në dispozicion që keni kur është fjala për gjithëpërfshirjen, siç u tha më lart.

6. Shkollat gjithëpërfshirëse

AKTIVITETI 4

Në Modulin 2 ju keni diskutuar për 'shkollën e mirë'. Tani në dyshe diskutoni dhe jepni përgjigje në pyetjen: Si e konceptoni një shkollë gjithëpërfshirëse?

Vendosni në mes (në formë kllasteri) sintagmën "shkollë gjithëpërfshirëse" dhe evidentoni përrreth elemente që ndërlidhen me të. Prezenton secili grup.

Siç promovohet në Deklaratën e Salamankës, qeveritë duhet të dizajnojnë sistemin arsimor që i përgjigjet nevojave të ndryshme në mënyrë që të gjithë nxënësit të kenë qasje në shkollat e rregullta që i akomodojnë ato në pedagogji me fëmijën në qendër të vëmendjes. Në këtë drejtim, fokusi ka qenë në 'zhvillimin e shkollës gjithëpërfshirëse', me qëllim të krijimit të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët pavarësisht nga feja, kultura, raca, gjinia dhe diversiteti që është një e drejtë themelore e çdo qenieje njerëzore. Nocioni 'për të gjithë' u zgjerua dhe u diskutua në hollësi:



"Shkollat duhet t'i pranojnë të gjithë fëmijët pavarësisht nga kushtet e tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera. Kjo duhet të përfshijë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe të talentuar, fëmijët e rrugës dhe të punës, fëmijët nga popullatat e largëta ose nomade, fëmijët nga pakicat gjuhësore, etnike ose kulturore, dhe fëmijët nga zona dhe grupe të tjera të pafavorizuara ose të marginalizuara. (UNESCO 1994, 6)"



Në praktikë, shkollat gjithëpërfshirëse ofrojnë mundësi për të siguruar që të gjithë fëmijët të kenë mundësi të njëjta për të arritur potencialin e tyre të zhvillimit dhe për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote në mjediset e tyre në shtëpi, shkollë dhe komunitet. Ky proces kërkon zhvillimin e proceseve të të gjithë shkollës në mënyrë që të promovojnë praktikatat gjithëpërfshirëse dhe mësimin cilësor që janë të përgjegjshëm ndaj nevojave individuale dhe stileve të ndryshme mësimore të nxënësve.

AKTIVITETI 5

Lexoni individualisht 12 karakteristikat kryesore të dhëna më poshtë. Pas leximit, dakordohuni të gjitha grupet dhe shtoni nga një karakteristikë nga secili grup.

Disa karakteristika kyçe të shkollës gjithëpërfshirëse janë: ⁸

- | | | |
|-----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| 1. | Ofron mjedis më së paku kufizues; | <input type="checkbox"/> |
| 2. | Ofron kurrikulë fleksibile; | <input type="checkbox"/> |
| 3. | Ofron të mësuarit bashkëpunues dhe mësimdhënien e përbashkët; | <input type="checkbox"/> |
| 4. | Ofron mbështetje shtesë dhe program të mësimit të individualizuar; | <input type="checkbox"/> |
| 5. | Është thellësisht e zotuar në besimin se të gjithë fëmijët mund të mësojnë; | <input type="checkbox"/> |
| 6. | Njeh se të gjithë nxënësit kanë nevoja të veçanta për mësim të një lloji ose tjetër; | <input type="checkbox"/> |
| 7. | Përqendrohet në nevojat e të mësuarit të nxënësve e jo në aftësitë e tyre të kufizuara të të nxënësve; | <input type="checkbox"/> |
| 8. | Ka pritje të larta prej nxënësve, përcakton objektiva të qarta të arritshme por sfiduese, shpërblen përpjekjet dhe i gëzohet suksesit; | <input type="checkbox"/> |
| 9. | Është e vëmendshme dhe përdor një gamë të personelit me kualifikime të shumëllojshme (p.sh. mësimdhënësit, specialistët, ndihmësit, vullnetarët dhe nxënësit e tjerë) për të ndihmuar nxënësit në të nxënësve; | <input type="checkbox"/> |
| 10. | Ka një performancë të fortë dhe kulturë zhvillimi që mbështet të gjithë stafin dhe shprehet vullnetare për të përmirësuar vazhdimisht efikasitetin e tyre për të nxitur mësimnxënien nga ana e nxënësve; | <input type="checkbox"/> |
| 11. | Ndihmon nxënësit të identifikojnë objektivat e të mësuarit, rregullisht monitoron performancën dhe ofron reagime konstruktive për nxënësit dhe prindërit për progresin e të nxënësve dhe sfidat, dhe si mund të arrihen këto; | <input type="checkbox"/> |
| 12. | Ofron lidhje të forta me prindërit dhe agjencitë tjera relevante, qendrat e rehabilitimit dhe palët e interesuara që synojnë përmirësimin e rezultateve të nxënësve. | <input type="checkbox"/> |

Secila prej karakteristikave ose praktikave të mësipërme ka për qëllim të ofrojë udhëzime lidhur me zhvillimin e shkollave gjithëpërfshirëse që i shërbejnë të gjithë nxënësve. Zbatimi i këtyre politikave dhe veprimeve mund të pasqyrojë se si ndodh mësimi si dhe rezultatet e fëmijëve.

6.1. Mjedisi shkollor

Ky kapitull ofron një hyrje se si të lëvizet përpara drejt arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë, bazuar në parimet kyçe të shkollës gjithëpërfshirëse, të tilla si:

- Vlerat, besimet dhe pritjet e shkollës
- Masat për mësimdhënie dhe mësimnxënie
- Praktikrat e mësimdhënies
- Mësimnxënia bashkëpunuese
- Mjediset më së paku kufizuese
- Udhëheqja e shkollës

Për të lehtësuar zbatimin e praktikës gjithëpërfshirëse dhe për të zhvilluar shkollat gjithëpërfshirëse, janë disa përbërës kyç që duhet të adresohen. Këta përbërës kyç në vijim përdoren për të përcjellë fushat për reflektim dhe veprim.

6.1.1 Vlerat, besimet dhe pritjet

Për të krijuar një kulturë gjithëpërfshirëse të shkollës që promovon të nxënit e përmirësuar për të gjithë nxënësit, shkolla duhet së pari të identifikojë një sërë vlerash dhe besimesh thelbësore për mësimnxënien që do të funksionojë si zotim themelor i përcaktuar për nxënësit dhe komunitetin⁸.

Në mënyrë ideale, në shkollën gjithëpërfshirëse ekziston besimi se të gjithë nxënësit mund të mësojnë së bashku pa marrë parasysh aftësisë ose aftësisë së tyre të kufizuar, dhe qëllimi i saj është të ndihmojë të gjithë nxënësit për të mësuar dhe për t'i mbajtur ata të angazhuar në mësimnxënie. Prandaj, ekziston një pritje që në një mjedis të tillë të karakterizuar nga barazia, mësimnxënia me nxënësin në qendër të vëmendjes dhe me punën bashkëpunuese nxënësit do t'i përvetësojnë kompetencat akademike, sociale dhe qytetare. Në disa shkolla gjithëpërfshirëse, drejtorët janë duke i miratuar vlerat e bazuara në zhvillimin e një ndjesie të përkatësisë për të gjithë anëtarët e komunitetit të shkollës përmes punës ekipore së tërë shkollës, vendimarrjes së përbashkët dhe kulturës gjithëpërfshirëse. Fokusi është në çështjet e pjesëmarrjes që shkojnë përtej mësimnxënies, të përfshihen, të vlerësohen, të njihen dhe të pranohen si anëtarë plotësisht pjesëmarrës të shoqërisë. Vlerësimi i diversitetit dhe ndryshimit shihet si një pjesë thelbësore e procesit të heqjes së pengesave ndaj gjithëpërfshirjes dhe rritjes së pjesëmarrjes së plotë dhe zvogëlimit të përjashtimit.

⁸ Asociacioni i New England i Shkollave dhe Kolegjeve, Inc. Guidebook.(2009). Zhvillimi i vlerave, besimeve themelore dhe pritjeve mësimore. Komisioni për Shkollat e Mesme Publike.

AKTIVITETI 6

Shihni tabelën më poshtë dhe diskutoni në gruppër vlerat dhe besimet në shkollën tuaj. Diskutoni Çfarë mungon nga ato në tabelën e paraqitur. Çfarë mund të bëni ju, për të promovuar ato vlera në shkollën tuaj?

Tabela mund të përdoret për të nxitur diskutimin...

Vlerat/besimet e rrënjësura në arsimin gjithëpërfshirës: a pajtoheni?

Cilat janë vlerat dhe besimet tona lidhur me..

1	...arsimi?	Ne besojmë se të gjithë kanë të drejtë në arsim.
2	...mësimnxënia?	Ne besojmë se të gjithë mund të mësojnë.
3	...vështirësitë në të nxënëit?	Ne besojmë se të gjithë mund të kenë vështirësi në të nxënëit në fusha të caktuara ose në kohë të caktuar.
4	...mbështetja në të nxënëit?	Ne besojmë se të gjithë kanë nevojë për mbështetje në mësimnxënien e tyre.
5	...përgjegjësia për mësimnxënien e fëmijës?	Shkolla, mësimdhënësi, familja dhe komuniteti kanë përgjegjësinë kryesore për të lehtësuar mësimnxënien – dhe jo vetëm nxënësin.
6	...dallimi?	Ne i vlerësojmë dallimet; ato janë normale dhe e pasurojnë shoqërinë.
7	...diskriminimi?	Duhet të sfidohen qëndrimet dhe sjelljet diskriminuese, për të përgatitur fëmijët dhe të rinjtë për një shoqëri gjithëpërfshirëse. Ne vlerësojmë një shoqëri tolerante që përfaqon diversitetin.
8	...mbështetja e mësimdhënësve?	Mësimdhënësit nuk duhet të izoloohen, ata kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme.
9	...kur fillon dhe përfundon arsimi?	Arsimi fillon që në lindje, në shtëpi. Edukimi në fëmijërinë e hershme është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe të nxënëit nuk ndalet me moshën madhore – mund të jetë një proces i të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Shtoni temat tuaja...

6.1.2. Masat e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Për t'iu përgjigjur dhe për t'i plotësuar nevojat e ndryshme të nxënësve, shkolla gjithëpërfshirëse do të duhej të optimizonte personelin dhe burimet në dispozicion për t'i mbështetur nxënësit. Shkolla gjithëpërfshirëse ka një varg burimesh të mësimdhënies dhe të nxënies në dispozicion të vet që do të lehtësonte zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Mësimdhënia e përbashkët mund të jetë mënyrë shumë e suksesshme për t'i mësuar të gjithë nxënësit në klasë. Angazhimi i mësimdhënësve gjithëpërfshirës/përkrahës krahas mësimdhënësit kryesor mund të jetë shumë efektiv për nxënësit me nevoja të veçanta, veçanërisht për ata me vështirësi të lehta. Mësimdhënësi gjithëpërfshirës mund të mbështesë jo vetëm nxënësit me nevoja të veçanta; ai mund të bashkëpunojë dhe të ndajë praktika të mira gjithëpërfshirëse me të gjithë mësimdhënësit brenda shkollës. Përgjegjësia e tij kryesore është të bashkëpunojë dhe mbështesë promovimin e arsimit gjithëpërfshirës përmes: ekipit të mësimdhënies së bashku me mësimdhënësit, përshtatjen e mësimëve të arsimit të përgjithshëm dhe mësimin e lëndëve të ndryshme, të tilla si leximi, shkrimi dhe matematika, nxënësit me vështirësi të lehta dhe të moderuara, përdorimi i aktiviteteve praktike me grupe të vogla fëmijësh me nevoja të veçanta ose punë individuale në dhomat e burimeve, sigurojnë që burimet e nevojshme për mësim të jenë në dispozicion për të mbështetur fëmijët e synuar, etj.

Nga ana tjetër, dhomat burimore/gjithëpërfshirëse janë njësi të vogla që sigurojnë hapësirë për punë individuale me fëmijët me nevoja të veçanta ose grup të vogël fëmijësh. Gjithashtu mund të përdoren për të prodhuar materiale didaktike për fëmijët me nevoja të veçanta. Nganjëherë ekziston keqkuptimi ose ato ngatërrohen me rolin e klasave speciale ose klasave të bashkangjitura brenda shkollës.

Funksioni i Qendrës Burimore⁹:

- Mbështet integrimin dhe përfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta
- Këshillim dhe rrjetëzim
- Mësimdhënësi udhëtues
- Trajnim pa shkëputje nga puna
- Monitorimi dhe vlerësimi i nevojave
- Zhvillimi i plan programit
- Hulumtimi dhe raportimi i praktikave të reja

Klasa speciale për fëmijët me nevoja të veçanta është zakonisht si një klasë e veçuar brenda shkollës së rregullt. Personeli përfshin një mësimdhënë të veçantë, i cili jep mësim në një klasë me numër të vogël nxënësish, moshash të përziera dhe nganjëherë me diagnoza të njëjta, për shembull, klasa speciale vetëm për fëmijët me çrregullim të spektrit autistik. Nxënësit mund të kalojnë të gjithë kohën e tyre në ato klasa ose mund të integrohen në klasa të rregullta në kohë të caktuara.

Synimi kryesor i klasës së posaçme (e njohur me emërtimin si klasë speciale apo klasë e bashkangjitur) është të shërbejë si “urë” për të lidhur klasat e veçanta (të bashkangjitura) me klasat e zakonshme, me qëllim që të lehtësojë integrimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në pro-

⁹ MASH. Funksionalizimi i Qendrës Burimore. <https://MASH.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijetnxeenit-me-afte-si-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene>

gramin e rregullt të arsimit. Qëllimi i këtyre klasave është pajisja e nxënësve me njohuri themelore dhe përgatitja e tyre për të marrë pjesë në mënyrë kuptimplote në klasat e rregullta. Klasat e bashkangjitura janë transformuar apo synimi është për t'u transformuar në “dhomat burimore” të cilat janë hapësira mësimore, me fokus në mbështetjen shitesë për fëmijët me nevoja të veçanta por që ndjekin klasat e rregullta. Duke iu referuar UA24/2014, shndërrimi i klasave të bashkangjitura në dhoma burimore janë përcaktuar edhe procedurat kur një mësimitdhënës i klasës së bashkangjitur kalon në mësimitdhënës mbështetës. Pas përfundimit të procesit të shndërrimit të klasës së bashkangjitur në dhomë burimore mësimitdhënësi i klasës së bashkangjitur kalon në mësimitdhënës mbështetës në nivel shkolle.

Shkollat gjithëpërfshirëse janë gjithashtu të lidhura me Qendrën Burimore që mund të luajë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e tyre në ngritjen e kapaciteteve, strategjitë e specializuara të mësimitdhënies, këshilla për planifikimin e njësive mësimore, vëzhgimin dhe informatat kthyesë.

6.2. Profilet e mësimitdhënësit në funksion të arsimit gjithëpërfshirës

Mësimitdhënësit në një klasë gjithëpërfshirëse e dinë se çdo nxënës është i veçantë dhe duhet të ofrojnë stile të ndryshme të të nxënësve në mënyrë që të maksimizojnë potencialin e tyre. Ata janë në gjendje të ofrojnë kurrikulë fleksibile dhe të zbatojnë stile të ndryshme të të mësuarit, në mënyrë që secili nxënës të jetë i angazhuar në një përvojë kuptimplote. Ata reflektojnë mbi strategjinë e tyre të mësimitdhënies dhe vazhdimisht kërkojnë të përmirësojnë aftësinë e tyre për të ofruar teknika dhe metodologji të përshtatshme që janë relevante për përvojat dhe nevojat e jetës reale të secilit fëmijë. Mësimitdhënësi në një klasë gjithëpërfshirëse siguron që të gjithë nxënësit, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, të kenë mundësi dhe zgjedhje që u mundësojnë atyre të marrin pjesë në gamën e plotë të programeve dhe shërbimeve që ofrohen brenda shkollës dhe komunitetit lokal. Ata janë në gjendje të organizojnë dhe krijojnë mjedisin e të nxënësve ku të gjithë nxënësit mund të marrin pjesë në mënyrë aktive dhe të kontribuojnë në mënyrë kuptimplote në aktivitetet e të nxënësve.

Shkollat gjithëpërfshirëse i kushtojnë vëmendje të veçantë angazhimit të prindërve, nxënësve dhe komunitetit në diskutimin e nevojave, qëllimit dhe synimeve të të nxënësve të nxënësve dhe për shndërrimin e këtyre diskutimeve në plane mësimore si udhëzime për përpjekjet e mësimitdhënies nga ana e nxënësve. Për secilin fëmijë me nevoja të veçanta hartohet një Plan Individual i Arsimit (PIA), për të cilin ekipi vlerësues i ekspertëve të fushave të ndryshme të zhvillimit vendos të ofrojë arsim të përshtatshëm sipas potencialit të tij. Ndërsa, mësimitdhënësit do të ofrojnë aktivitete të përshtatshme mësimore dhe mbështetje shitesë në përputhje me synimet dhe objektivat e PIA.

6.2.1. Mësimdhënësi gjithëpërfshirës

AKTIVITETI 7

Duke pasur parasysh që tani diskutuam për arsimin gjithëpërfshirës dhe shkollën gjithëpërfshirëse, diskutoni në grup dhe 'portretizoni' mësimdhënësin gjithëpërfshirës. Evidentoni së paku nga 5 karakteristika.

Lexoni pjesën në vijim për profilin e mësimdhënësit gjithëpërfshirës dhe identifikoni të përbashkëtat dhe dallimet nga ajo që keni përshkruar ju.

Profili është zhvilluar rreth kësaj kornize të vlerave thelbësore dhe fushave të kompetencës:

- Vlerësimi i diversitetit të nxënësit - ndryshimi i nxënësit konsiderohet si një burim dhe një aset për arsimin.

Fushat e kompetencës brenda kësaj vlere thelbësore kanë të bëjnë me:

- Konceptet e arsimit gjithëpërfshirës;
- Pikëpamja e mësimdhënësit për ndryshimin e nxënësit.
- Mbështetja e të gjithë nxënësve – mësimdhënësit kanë pritje të mëdha për të gjitha arritjet e nxënësve.

Fushat e kompetencës brenda kësaj vlere thelbësore kanë të bëjnë me:

- Promovimi i mësimin akademik, praktik, shoqëror dhe emocional të të gjithë nxënësve;
- Qasje efektive të mësimdhënies në klasat heterogjene.
- Puna me të tjerët - bashkëpunimi dhe puna në ekip janë qasje thelbësore për të gjithë mësuesit.

Fushat e kompetencës brenda kësaj vlere thelbësore kanë të bëjnë me:

- Puna me prindërit dhe familjet;
- Duke punuar me një sërë profesionistësh të tjerë arsimor.
- Zhvillimi Profesional Personal - mësimdhënësia është një veprimtari mësimore dhe mësimdhënësit marrin përgjegjësi për të nxënëit e tyre gjatë gjithë jetës.

Fushat e kompetencës brenda kësaj vlere thelbësore kanë të bëjnë me:

- Mësimdhënësit si praktikues reflektues;
- Arsimi fillestar i mësimdhënësve si një themel për të nxënë dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional.

6.3. Shërbimet mbështetëse

“Shkollat e rregullta me orientim gjithëpërfshirës janë mënyra më efikase për luftimin e diskriminimit, krijimin e komuniteteve mikpritëse, ndërtimin e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe arritjen e arsimit për të gjithë”
Deklarata e Salamankes dhe Korniza për Veprim 1994, Neni 2

AKTIVITETI 8

Ndahuni në grupe.

- Grupi 1:** Lexon dhe prezenton pjesën: Shërbimet mbështetëse për plotësimin e nevojave të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar në Kosovë;
- Grupi 2:** Lexon dhe prezenton pjesën: Profili i mësimit mbështetës;
- Grupi 3:** Lexon dhe prezenton pjesën: Profili i edukatorit/es mbështetës;
- Grupi 4:** Lexon dhe prezenton pjesën: Profili i mësimit udhëtues;
- Grupi 5:** lexon dhe prezenton pjesën: Profili i asistentit.

Shërbimet mbështetëse për plotësimin e nevojave të veçanta arsimore në arsimin para-universitar në Kosovë:

- Në MASH, Divizioni për Arsimit me Nevoja të Veçanta (DANV) vepron në kuadër të Departamentit të Politikave të Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe përbëhet nga katër ekspertë dhe një administrator.
- Drejtoritë Komunale të Arsimit administrojnë punën e shkollave në komunë. Komunitet në Kosovë kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive në ofrimin e arsimit publik parafillor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve arsimore, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e mësimit dhe administratorëve të arsimit. (Ligji Nr. 03 / L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Neni 17).
- Zyrtarët mbështeten nga DANV me trajnime të vazhdueshme që lidhen me fushën e arsimit gjithëpërfshirës / nevoja të veçanta, me zbatimin e ligjit, PSAK-ut, udhëzimeve administrative etj. Zyrtarët e arsimit gjithëpërfshirës mbajnë takime të rregullta me DANV për të marrë këshilla dhe përkrahje dhe për të shkëmbyer informacione rreth përvojave.
- Ekipet vlerësuese profesionale të komunës. Ligji për Arsimin Parauniversitar (neni 41) parasheh që secila komunë, vetëm ose në bashkëpunim me komunat e tjera, do të krijojë një ekip profesional vlerësues dhe mbështetës për nevoja të veçanta arsimore për të siguruar mbështetje të jashtme për institucionet arsimore dhe/ose trajnuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimit, nxënësit dhe prindërit. Deri më tani, 28 komuna kanë themeluar ekipet e vlerësimit. DANV ka zhvilluar dhe ofruar një instrument me udhëzime rreth përdorimit të tij nga ekipet vlerësuese komunale dhe ekipet vlerësuese janë trajnuar për përdorimin e këtij instrumenti. Struktura e ekipit vlerësues përbëhet nga: zyrtari i DKA-së për arsimin gjithëpërfshirës, psikologu, punëtori social, mësimit gjithëpërfshirës (mbështetës), mësimit i Qendrës Burimore, specialisti i rehabilitimit varësisht nga lloji i nevojës së veçantë. Prindi / kujdestari duhet të konsultohet gjatë kohës së vlerësimit.

- Ekipet mbështetëse. Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2014 përcakton se shkollat duhet të krijojnë ekipe mbështetëse për të mbështetur transferimin e nxënësve nga klasat e bashkangjitura në klasa të rregullta. Ekipi Mbështetës përbëhet nga anëtarët në vijim: drejtori i shkollës, mësimitdhënësi i klasës së bashkangjitur dhe mësimitdhënësi mbështetës, psikologu apo pedagogu ose një mësimitdhënësi i trajnuar në arsimin gjithëpërfshirës.

Me qëllim të krijimit të sistemit arsimor gjithëpërfshirës, fokusi kryesor duhet të jetë mbi atë që po ndodh në klasat e rregullta dhe se si të mbështeten mësimitdhënësit e zakonshëm për t'i përfshirë dhe për t'i përmbushur nevojat e ndryshme në klasë.

Në Kosovë funksionojnë disa mekanizma të cilët i mbështesin institucionet edukative dhe arsimore si: mësimitdhënësi mbështetës, edukatori mbështetës dhe asistenti për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta. Këto profile të mësimitdhënësve dhe edukatorëve mbështetës si dhe asistentëve, tani janë aktive në disa institucione parashkollore dhe shkolla të cilët kanë rolin e mbështetjes profesionale dhe asistencës nëpër institucione parashkollore dhe shkolla dhe janë nën kompetencën e Drejtorive Komunale të Arsimit dhe vetë shkollave, ndërsa roli i MASH-it është hartimi i politikave dhe monitorimi i tyre në terren.

Mësimitdhënësi mbështetës: ka statusin e njëjtë sikurse të gjithë mësimitdhënësit e tjerë brenda një shkolle, por fokusi i punës së tij janë nxënësit me nevoja të veçanta arsimore. Mësimitdhënësit mbështetës duhet të planifikojnë mësimitdhënien, të përdorin metoda dhe teknika të mësimitdhënies që ju përshtaten nevojave, talenteve si dhe stileve të ndryshme të të nxënësve dhe të mundësojnë që secili nxënës pa marrë parasysh dallimet të jetë i përfshirë në aktivitetet në klasë dhe të përfitoj nga të nxënësve.

Edukatore/ja mbështetës/e; është me status të njëjtë sikurse të gjitha edukatorët në institucion parashkollor, por fokusi i tij/saj janë fëmijët me nevoja të veçanta. Ata duhet të krijojnë shprehje dhe të promovojnë barazinë në grupe-moshë/klasë ku secili fëmijë të ndjehet i respektuar dhe çmuar si individ, njëkohësisht duhet të ketë një bashkëpunim të ngushtë me tërë stafin e institucionit parashkollor në veçanti me edukatorët e grup- moshave në të cilën është fëmija dhe i ofrohet mbështetje, te edukatorët e para dhe përgjegjëse të fëmijës.

Asistenti: asistenti në klasë në masë të madhe mund të përmirësojë cilësinë e procesit mësimor, duke iu ndihmuar në radhë të parë dhe direkt fëmijëve/nxënësve. Asistenti përcaktohet në rastet kur ekipi vlerësues pedagogjik komunal vlerëson dhe rekomandon se një fëmijë/nxënës i duhet një mbështetje nga asistenti.

Psikologu: i cili ofron shërbime psikologjike në institucione parashkollore dhe shkolla në përputhje me politikën e zhvillimit të arsimit dhe institucionit edukativ/arsimor i cili fokusohet në promovimin dhe zhvillimin psiko-fizik të fëmijëve/nxënësve si dhe lehtësimin e mësimitdhënies. Psikologu bashkëpunon me personelin administrativ dhe pedagogjik për realizimin dhe ofrimin e shërbimeve të drejtpërdrejta për fëmijët/nxënësit, po ashtu ofron shërbime këshilluese dhe trajnuese për stafin e institucionit edukativ/ arsimor dhe prindërit.

Pedagogu: përqendrohet në zhvillimin profesional të mësimitdhënësve dhe zhvillimin e profileve të nxënësve në bashkëpunim me mësimitdhënësit, duke përdorur teknika dhe metoda bashkëkohore si dhe është bashkëpjesëmarrës në hartimin e PIA-së.

6.3.1. Profili i mësimitdhënësit mbështetës

Detyrat dhe roli i mësimitdhënësit mbështetës:

- Identifikon nxënësit që kanë nevoja të veçanta arsimore dhe vlerëson ato nevoja
- Planifikon dhe organizon bashkë mësimitdhënie me mësimitdhënësin e rregullt në klasa ku ka nxënës me nevoja të veçanta arsimore
- Kur është e nevojshme tërheq një grup më të vogël të nxënësve për t'ju ofruar mësimitdhënie të veçantë në ndonjë lëndë të caktuar
- Përpilon planin individual të arsimit bashkë me mësimitdhënësin e rregullt, prindin dhe kur është e mundur edhe vetë nxënësin me nevoja të veçanta arsimore
- Përkujdeset që plani individual i arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore të rishikohet dhe vlerësohet në periudha të rregullta kohore dhe kohë pas kohe të ripunohet nëse ka nevojë
- Të bashkëpunojë me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe me mësimitdhënësin e rregullt për të definuar synime dhe objektiva reale arsimore për fëmijën
- Këshillon mësimitdhënësit se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore
- Jep këshilla dhe përpilon materiale mësimore alternative bashkë me mësimitdhënësin e klasës së rregullt të cilat do të përdoren në mësimitdhënien me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore
- Ndihmon në vetëdijesimin e stafit të shkollës për procesin e gjithëpërfshirjes
- Ndihmon drejtorin e shkollës dhe stafin tjetër udhëheqës për akomodimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore dhe për të plotësuar nevojat e larmishme të tyre
- Në bashkëpunim me mësimitdhënësin udhëtues dhe Qendrat Burimore ndihmojnë në identifikimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore që janë jashtë shkollës dhe ata që janë në shkollë por që nuk marrin mbështetje adekuate.
- Bashkëpunon me mësimitdhënësin e klasës së bashkangjitur në shkollën ku punon dhe planifikojnë së bashku mbështetjen për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore që janë në klasa të rregullta në shkollë
- Bashkëpunon me Qendrat Burimore rreth metodave të mësimitdhënies, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore në klasa të rregullta.

6.3.2. Profili i edukatorit/es mbështetës

Edukatori mbështetës ndër të tjera ka edhe këto detyra dhe përgjegjësi :

I realizon qëllimet dhe detyrat e arsimit dhe edukimit parafillor;

- Planifikon dhe realizon planin vjetor, mujor të punës edukative dhe arsimore si dhe zhvillon aktivitete të përbashkëta me edukatorët e grup-moshave të ndryshme;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimitdhënies duke marrë parasysh nevojat indi-

- viduale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore sipas grupmoshave;
- Përdor metoda dhe teknika bashkëkohore të mësimdhënies duke marrë parasysh nevojat individuale të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore sipas grupmoshave;
- Harton plane individuale për fëmijët me nevoja të veçanta (në bashkëpunim me edukatoren, prindërit apo kujdestarë të fëmijëve, me asistent personal si dhe me stafin profesional të institucionit);
- Bashkëpunon me ekipin për identifikim dhe vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në nivel komunal;
- Sipas Ua 24/2014, neni 5 pika 4 sipas nevojës kur është e domosdoshme punon individualisht me fëmijët jashtë grup- moshës;
- Ndihmon edukatoren në punë me fëmijë me nevoja të veçanta dhe si të menaxhohet puna me tërë grupin;
- Në bashkëpunim me edukatoren e grupit hartojnë materiale alternative për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore;

6.3.3. Profili i mësimdhënësit udhëtues

Mësimdhënësit udhëtues janë profesionist në fushën e edukimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Puna e tyre fokusohet jashtë qendrës burimore, për të ofruar mbështetje nxënësve dhe mësimdhënësve në shkolla, por edhe brenda qendrës në shërbimet e mbështetjes. Mësimdhënësit udhëtues kanë rol shumë dimensional dhe për veç mbështetjes specifike për nxënës me nevoja të veçanta.

Mësimdhënësit udhëtues mbulojnë edhe fushat tjera që lidhen me promovimin e arsimit gjithëpërfshirës si :

- Identifikimin e nevojave për mbështetje të fëmijët me nevoja të veçanta në shkolla;
- Vlerësimin e nevojave për mbështetje pedagogjike;
- Përkrahin procesin e tranzicionit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore nga qendrat burimore në shkollat e rregullta;
- Këshillimin e mësimdhënësve, shërbimeve pedagogjike dhe drejtorëve;
- Dhënien e këshillave lidhur me pajisjet dhe materialet e nevojshme për nxënësit;
- Hartimin, shkrimin dhe rishikimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) në bashkëpunim me mësimdhënësit dhe prindërit;
- Modifikimin e përmbajtjes së kurrikulës, strategjive të mësimdhënies, materialeve dhe vlerësimi në bazë të nevojave individuale të nxënësve;
- Intervenimin dhe përgatitjen e planeve mësimore;
- Realizon punë individuale me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore, (sipas nevojës - mësim shtesë në qendrën burimore); • Mban trajnime për mësimdhënëset e qendrës burimore sipas kërkesave dhe nevojave mësimore;
- Ndihmon mësimdhënëset e qendrës në kuptimin dhe zbërthimin e aftësive sipas fushave të aktiviteteve mësimore;
- Monitorimin e përparimit të arritjeve për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- Ofron rekomandime dhe sugjerime për të krijuar materialet didaktike të duhura dhe alternative;

- Modifikon materialet në sistemin Brail;
- Identifikimi i nevojave për mbështetjen e stafit mësimdhënës në shkolla;
- Bashkëpunon me DKA-të, OJQ-të;
- Bashkëpunon me ekipet në qendrën burimore;
- Bashkëpunon me rrjetin e mësuesve udhëtues;
- Krijimi i bazës së të dhënave për procesin e mbështetjes.

6.3.4. Profili i asistentit

Detyrat dhe përgjegjësitë e asistentit për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta:

- Ndihmon fëmijët/nxënësit në zhvillimin dhe promovimin e pavarësisë, orientim dhe mobilitet, transport, pozitën dhe uljen e nxënësit në klasë.
- Bashkëpunon me mësimdhënësit dhe stafin tjetër për zbatimin e PIA-së, lëndë të individualizuara ose mësim në fusha të aktiviteteve.
- Përgatit materiale mësimore si dhe menaxhon me pajisjet e nevojshme brenda dhe jashtë klasës.
- Vëzhgon dhe dokumenton vështirësitë dhe nevojat e identifikuar të fëmijëve, përgatit informata kthyesë për vështirësitë dhe arritjet e fëmijëve.
- Promovon arsimin gjithëpërfshirës dhe pranimin e të gjithë fëmijëve me NV në klasë, inkurajon fëmijët në komunikim, për pjesëmarrje në lojë dhe stimulimin e të folurit dhe gjuhës përmes bisedës dhe lojës.
- Mbikëqyrë dhe ndihmon fëmijët/nxënësit gjatë racioneve ushqimore, kujdeset për nevojat fizike-fiziologjike dhe mjekësore të nxënësve dhe asiston në veshjen dhe pastërtinë e përgjithshme të tyre.
- Promovon bashkëpunimin shkollë-shtëpi, mbështetë dhe diskuton çështje të ndjeshme me prindin/kujdestarin.
- Prezenton punën dhe arritjet e nxënësve. Informacionet në shkollë/institucion i trajton si plotësisht konfidenciale.
- Përdorë pajisje specifike audiovizuale, teknologjike për të ndihmuar procesin e të nxënësve.
- Paraqet punën dhe arritjet e nxënësve/ve, plotëson dosjet/ portfoliot e nxënësve/ve.
- Bashkëpunon me njerëzit profesional në shkollë/institucion si: pedagog, psikolog etj.

Mësimdhënësit duhet të përshtaten me kalimin nga përvoja e mësimdhënies ballë për ballë në udhëzimet në distancë. Por, në këtë ndryshim të papritur, mësimdhënësit mund të përballen me sfida shtesë në lidhje me përdorimin e teknologjisë dhe të pajisjeve dhe gjithashtu për të gjetur strategjitë më të mira për hartimin e kurrikulës në mjedisin në mësimin online. Duke marrë parasysh arsyet e veçanta, deri në çfarë mase mësimdhënësit janë të gatshëm dhe të aftë të bëjnë dallimin dhe adresimin e të gjithë nxënësve në klasën virtuale, në veçanti për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore (Frumos, 2020)?

7. Të mësuarit së bashku

Mjedisi i favorshëm në klasë ose mund të përmirësojë ose të pengojë aftësinë e nxënësve për të mësuar. Mirëqenia emocionale e nxënësve ndikon në aftësinë e tyre për të mësuar dhe ka shumë faktorë që ndikojnë në mirëqenien e tyre të përgjithshme. Atmosfera në klasë është një nga këta faktorë; atmosferat e klasës që kujdesen për mirëqenien emocionale të të gjithë anëtarëve ndikojnë jo vetëm në rezultatet e tyre të mësimin, por edhe në zhvillimin e tyre emocional. Hulumtimi arsimor mbështet krijimin e një atmosfere të respektit të ndërsjellë, ku nxënësit ndjehen të lirë për të bërë pyetje dhe për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tyre (Stronge, 2002). Duke pasur parasysh këtë, të rriturit në të gjitha kontekstet shoqërore, jo vetëm në familje ose në komunitet, por edhe në mjediset e shkollës, janë faktorë vendimtarë dhe model për nxitjen e zhvillimit të një raporti të tillë midis mirëqenies emocionale dhe arritjeve akademike tek fëmijët.

Ka shumë nisma që kanë studiuar faktorët që ndikojnë në procesin e të nxënësve.. Ato ndiqen nga një numër i teknikave ose fushave të ndërhyrjes që janë dokumentuar si efektive për arritjen e rezultatit të dëshiruar në performancën akademike të fëmijëve. Disa fusha që duhet të merren parasysh gjatë krijimit të atmosferës me respekt të ndërsjellë janë dizajnimi i klasës, procedurat në klasë dhe strategjitë e klasës (Bucholz, 2009). Më poshtë do të diskutohen disa fusha të ndërhyrjes që mund t'ju ndihmojnë mësimeve në përpjekjet e tyre për të përmirësuar mirëqenien e nxënësve të tyre si dhe performancën e tyre.

7.1. Klasat gjithëpërfshirëse

AKTIVITETI 9

Diktoni në grup, si mund të inkurajoni mësimeve të shkollës tuaj, për të krijuar dhe menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse. Si mund të përfshihen në këtë çështje pedagogu, psikologu, mësimeve të profilit që u diskutuan më lartë?

Shkollat që synojnë të përfshijnë në mënyrë aktive të gjithë fëmijët duke përdorur mënyra të ndryshme të mësimeve dhe promovojnë praktikën e diversitetit mësimeve gjithëpërfshirëse. Zbatimi i një sistemi të përfshirjes në shkollë promovon zhvillimin e ndërvprimeve shoqërore, ku çdo fëmijë ndjen një ndjenjë të përkatësisë.

Një klimë gjithëpërfshirëse në klasë i referohet një mjedisi ku të gjithë nxënësit ndihen të mbështetur intelektualisht dhe akademikisht dhe u shtrihet një ndjenjë e përkatësisë në klasë pavarësisht nga identiteti, preferencat e të mësuarit ose arsimimi. Mjedise të tilla mbështeten kur mësimeve të shkollës dhe nxënësit punojnë së bashku për mendueshmëri, respekt dhe përsosmëri akademike dhe janë thelbësore për të inkurajuar suksesin akademik të të gjithë nxënësve .

➔ Grupet e tryezave të vendosura rreth klasave gjithëpërfshirëse

Grupimi i studentëve u jep atyre një mundësi për të bashkëvepruar me shokët e tyre të klasës, si dhe të lidhen dhe të mësojnë prej tyre gjithashtu. Ekzistojnë efekte të shumta pozitive të përdorimit të kësaj qasjeje si një nxitje e papritur e vetëvlerësimit, marrëdhënie të shëndetshme ndërmjet grupeve, respekt për studentët me të meta akademike, qëndrim pozitiv ndaj shkollës dhe aftësia për të punuar si lojtar ekipi.

➔ Teknologji ndihmëse gjerësisht e disponueshme

Teknologjia ndihmëse duhet t'u sigurohet lehtësisht studentëve për të mbështetur interesat, stilet dhe nevojat e tyre individuale. Teknologjia e fundit, siç janë kapjet adaptive të lapsit, aplikimet ndërvepruese, mjetet e komunikimit miqësore për fëmijë dhe mbivendosjet e ngjyrave janë të gjitha të dobishme për ta bërë më të lehtë për fëmijët me nevoja të veçanta që të përfshihen në diskutime shkollore dhe të marrin pjesë në aktivitete gjithashtu.

➔ Ndhimat krijuese të të nxënit vizual që përdoren në klasat gjithëpërfshirëse

Mbështetjet vizuale zakonisht përdoren në klasat gjithëpërfshirëse. Ndhima të tilla si organizatorët vizualë tradicionalë dhe modernë - qofshin këto të krijuara nga një student, mësues apo kompani teknologjike, mund t'i ndihmojnë studentët të tejkalojnë dukshëm kolegët e tyre që nuk i përdorin këto mjete. Materialet e tjera vizuale janë gjithashtu efektive. Një traditë e zakonshme (sidomos në klasat parashkollore) është që gjithçka të jetë me ngjyra sa më shumë që të jetë e mundur. Oraret ditore, në formë pikturë ose të shkruar, shpesh vendosen në një vend të spikatur për të ndihmuar në kuptimin e konceptit të ditës dhe kohës. Për të kujtuar konceptet, tabelat mund të përdoren për t'i ndihmuar nxënësit të kuptojnë temat dhe në të njëjtën kohë, t'i shtojnë ata të mbajnë mësimet e përditshme dhe t'i zbatojnë ato në jetën e tyre të përditshme në shtëpi.

Përveç kësaj, teknologjia moderne shtyn gjithashtu për materiale më interaktive dhe të dobishme mësimore. Disa aplikacione i ndihmojnë studentët në skemat matematikore dhe vizatimet me tinguj dhe ngjyra krijuese. Më në fund, në një klasë gjithëpërfshirëse, nuk do të ketë mungesë të etiketave, simboleve dhe fotografive të vendosura nëpër dhomë për të ndihmuar studentët të identifikojnë zonat e të mësuarit, furnizimet, materialet dhe sendet me interes.



(<https://iqmaward.com/uncategorized/characteristics-of-an-inclusive-classroom/>).

➔ Strukturim i komunikimit në klasë për të inkurajuar pjesëmarrjen me respekt dhe të drejtë

Mësimdhënësit mund të vendosin rregulla themelore ose udhëzime specifike për sjelljen e duhur në fillim të vitit shkollor (duke përfshirë konfidencialitetin, mosmarrëveshjen e respektuar dhe debatin civil); Nxënëse mund t'u ofrohet kohë e mjaftueshme për të menduar për përgjigjet e pyetjeve kryesore ose për të shkruar pyetje të reja para se të përgjigjen.

➔ Përdorim i grupeve të vogla për të inkurajuar mënyra jo-konkurruese të të nxënit dhe për të inkurajuar komunikimin ndërkulturor

Nëse modelet e ndarjes së ulëseve në klasë janë të lidhura me modelet e mospjesëmarrjes, mësimdhënësit

mund të caktojnë grupe të vogla me diversitete të bdryshme. Nëse disa nxënës hezitojnë të flasin në klasë, ata mund të kontribuojnë së pari në grupe të vogla. Mësimdhënësit duhet t'i kushtojnë vëmendje të kujdesshme dinamikës së grupeve dhe të ndërhyjnë nëse disa nxënës përjashtohen nga pjesëmarrja e plotë dhe / ose studentë më të vendosur fillojnë të dominojnë.

➔ Parashikim i çështjeve të ndjeshme dhe prairi i ndryshimet racore, klasore ose kulturore në klasë
Kur diskutohen çështje të diskutueshme, mësimdhënësit duhet të presin përgjigje emocionale apo edhe konflikt.

➔ Modelim i gjuhës gjithëpërfshirëse
- Si një element i zhvillimit të një ambienti të respektueshëm, gjithëpërfshirës, mësimdhënësit mund të jenë të vetëdijshëm për praktikën gjuhësore që modelojnë. Duhet përdorur gjuhë e përshtatshme për të gjithë pa asnjë dallim.

➔ Përdorim i shembujve të shumëfishtë dhe të ndryshëm
Përdorim i shembujve multikulturorë me pamje dhe materiale sa më shumë që të jetë e mundur

Kur zbatohet mirë, arsimit gjithëpërfshirës siguron arsim më cilësor për nxënësit. Këtu janë disa nga karakteristikat e klasave gjithëpërfshirëse:

7.1.2. Klasat e dekoruara dhe të organizuara

Në përgjithësi, në kontekstin tonë më pak vëmendje i kushtohet kushteve fizike në të cilat fëmijët mësojnë; megjithëse kjo është studiuar gjerësisht dhe pranohet rëndësia e tyre në arritjen e përgjithshme akademike. Një mjedis i mirë zbukuruar dhe i organizuar është një mjedis mikpritës. Çdo gjë që shkakton ndjenjën e rehatisë mund të ndihmojë në proceset e të nxënës: ngjyrat e klasës, karriget dhe bankat e rehatshme, jastëkët ose çfarëdo materiali tjetër në dispozicion që mund të shtojë ngrohtësi në mjedis. Fëmijët mësojnë në mjedise të rehatshme dhe aty ku ata kanë qasje në të gjitha materialet e nevojshme në varësi të metodës së tyre të të nxënës (audio, vizuale ose kinestetike).

Një tjetër faktor fizik që ndikon në performancën e tyre është gjithashtu metoda se si rregullohen bankat. Nxënësit mësojnë më mirë kur janë në pozitë shoqëruese me moshatarët e tyre.

7.1.3. Takimet në klasë

Klasat nuk janë mjedise të ngurta dhe nxënësit e dinë se si sfidat dhe mendimet e tyre duhet të vlerësohen në procesin e zgjidhjes së tyre. Takimet mund të përmbajnë tema të ndryshme dhe të cilat mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve, por më së shumti ato janë gjithashtu një mjet i mirë për shqyrtimin e nivelit të ndërveprimit shoqëror dhe proceseve mësimore (p.sh. në një lëndë të caktuar). Takimet në klasë mund t'i inkurajojnë fëmijët të punojnë së bashku për të zgjidhur problemet gjatë ushtrimit të aftësive pro-sociale (Bucholz & Sheffler, 2009).¹⁰

¹⁰ Bucholz, J. L. & Sheffler, J. (2009). Krijimi i mjedisit të ngrohtë dhe gjithëpërfshirës i klasës: Planifikimi që të gjithë fëmijët të ndjehen të mirëseardhur. Revista elektronike për arsimin gjithëpërfshirës 2(4).

7.1.4. Klasat respektuese

Siç u përmend më lart, të rriturit janë model për sjelljen e fëmijëve. Vlerat e mësimdhënësve si dhe animet e tyre reflektohen në mesin e nxënësve; prandaj ata nxisin ose dëmtojnë respektin e ndërsjellë në klasë. Për të krijuar një klasë respektuese, mësimdhënësi duhet të vërejë ndërveprimet e nxënësve dhe të përcjellë nëse diçka e pazakontë ose e dëmshme po ndodh dhe të mos tregojë tolerancë për përjashtimin social ose ngacmimin e personave brenda atij mjedisi (Eessler, 2003)¹². Një nga sjelljet e mosrespektimit që vërehen më së lehti janë ato kur njerëzit përdorin fjalë, fjali ose komente degraduese bazuar në pamjen fizike, aftësinë e kufizuar (intelektuale ose fizike), kulturën ose përkatësinë shoqërore ose nivelin socio-ekonomik të të tjerëve. Prandaj, mësimdhënësit nuk duhet të tolerojnë një sjellje të tillë dhe duhet të ndërpresin gjuhën degraduese. Ndërhyrja në një situatë të tillë dhe marrja e masave për të parandaluar atë që të ndodhë përsëri do të shmangin përsëritjen e situatave të tjera të rënda të dhunës.

Klasat respektuese mësojnë të kundërtën e asaj që përshkruhet më sipër; nxisin dhe ndihmojnë në rritjen e marrëdhënieve të bazuara në respekt të ndërsjellë. Nxënësit vëzhgojnë mësimdhënësit për të parë se si ndërveprojnë me mjedisin shoqëror dhe moral. Modelet e vendosura nga të rriturit në klasë dhe jashtë klasës luajnë një rol shumë të madh në zhvillimin e klasës respektuese. Kur nxënësit vëzhgojnë mësimdhënësit, ata mund të vlerësojnë se çfarë është e vërtetë dhe se çfarë po aktohet.

Fëmijët lulëzojnë me sinqeritet. Ata e meritojnë të kalojnë kohën e tyre në klasa ku mësimdhënësit e respektojnë nevojën për ndershmëri dhe integritet (Miller dhe Pedro, 2006).

7.1.5. Mjediset më pak kufizuese

Procesi i të nxënësve bazohet në krijimin e një mjedisi që gjeneron ndjenjat e të qenit i vlerësuar si një anëtar i rëndësishëm i bashkësisë në klasë. Gjithëpërfshirja është e mundur vetëm kur jemi në gjendje të krijojmë kontekste të tilla mbështetëse mësimore. Mjediset mbështetëse krijojnë mundësi për nxënësit që të dalin nga zona e rehatisë, në mënyrë që të jenë në gjendje t'a shprehin veten e tyre dhe të kërkojnë ide të reja. Ata nxisin punën në grupe, duke marrë rolet udhëheqëse dhe duke nxitur përgjegjësinë e nxënësve për vetë procesin e tyre të të nxënësve.

Çdo nxënës mbetet person i veçantë me një sërë aftësisë dhe preferencash mësimore të veçanta. Mësimdhënësit në mjediset gjithëpërfshirëse vëzhgojnë dhe gjejnë informata rreth interesave të nxënësve, të cilat informata janë të rëndësishme për përgjigjen pozitive ndaj performancës dhe kontributit të nxënësve. Ata janë duke punuar vazhdimisht dhe në mënyrë aktive në ndërtimin dhe forcimin e mëtuqeshëm të marrëdhënieve ndërmjet nxënësve. Puna ekipore, bashkëpunimi, ndershmëria dhe respekti për njëri-tjetrin janë shumë të rëndësishme për klasën e tyre. Vlerat e sipërpërmendura synojnë arritjen e asaj që pritet për të kontribuar në mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta, kur është e nevojshme.

Një tjetër tipar i rëndësishëm i shkollave gjithëpërfshirëse është mjedisi fizik. Mësimdhënësit në shkollat gjithëpërfshirëse janë të vetëdijshëm për rëndësinë që kanë mjediset fizike në eksplorimin

e aftësive dhe mundësive mësimore të nxënësve. Ata janë gjithashtu të vetëdijshëm për ndikimin e hapësirës fizike në praktikën e mësimdhënies. Prandaj, ata vazhdimisht ndërhyjnë dhe ndryshojnë kushtet fizike të klasës së tyre për t'iu përshtatur më mirë nevojave dhe preferencave të nxënësve për mësim.

Përveç kësaj, shkollat gjithëpërfshirëse janë shumëdimensionale; ato përdorin mësimin ekipor me mësimdhënës ose vullnetarë të ndryshëm, si dhe u japin rëndësi grupeve të të nxënësve në klasë duke rritur fleksibilitetin në madhësinë dhe përbërjen. Kjo mund të përfshijë bashkimin e hapësirave mësimore në një të madhe ose ndarjen e hapësirave më të mëdha në ato më të vogla. Në raste të tjera, mësimi në klasë dhe hapësira në natyrë kombinohen. Modifikime të mëtejshme të mjedisit mësimor mund të bëhen duke krijuar grupe të strukturuar të lojës, lexime në vetvete ose të mësuarit në grupe më të vogla në një mjedis me lodra dhe mjete të tjera mësimore, të cilat stimulojnë imagjinatën dhe zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve.

7.2. Udhëheqja e shkollës

Shkollat gjithëpërfshirëse ndryshojnë nga shkollat e tjera për shkak të një sërë politikash dhe praktikash. Shkollat gjithëpërfshirëse ndërmarrin veprime për të ndryshuar praktikën dhe strukturën e tyre sipas nevojës, për të përmbushur parimet e arsimit gjithëpërfshirës në të cilat ata besojnë. Nga ana tjetër, duhet të përdoren strategji për t'iu qasur këtyre veprimeve që synojnë përmirësimin sipas parimit të arsimit gjithëpërfshirës.

Shkollat që kanë përqafuar tashmë zotimin për gjithëpërfshirjen nuk mund të kërkojnë ndryshime në shkallë të gjerë, megjithëse shkollat që nuk pasqyrojnë besimet dhe praktikën e arsimit gjithëpërfshirës mund të kenë nevojë të ndërmarrin një ndryshim thelbësor. Pritjet dhe besimet duhet të rishikohen dhe ndryshohen, kështu që duhet të modifikohet mjedisi mësimor, praktikën e mësimdhënies dhe përgjegjësitë e stafit të shkollës. Roli i udhëheqjes në ndryshime të tilla është vendimtar.

Udhëheqësit e shkollave në shkollat gjithëpërfshirëse janë të aftë të kalojnë nëpër ndryshime të tilla drejt krijimit të një kulture të shkollës e cila bazohet në gjithëpërfshirjen dhe që kërkon përmirësim të vazhdueshëm. Ata jo vetëm që sigurojnë udhëheqjen e kurrikulës, por edhe vazhdimisht mbrojnë dhe promovojnë marrëdhëniet e mira të stafit të shkollës me prindërit si dhe me komunitetin në përgjithësi. Artikulimi i një vizioni për shkollën e tyre është thelbësor dhe në këtë proces ata punojnë me stafin si dhe me komunitetin për të vendosur praktikën që mbështet të gjithë të përfshirë në përkthimin e vizionit të arsimit gjithëpërfshirës në praktikë.

Udhëheqësit me vizion gjithëpërfshirës janë të përkushtuar në përmirësimin dhe krijimin e mundësive arsimore për të gjithë nxënësit me aftësi, shkathtësi apo prejardhje të ndryshme. Strategjitë afatgjata, mjedisi fizik dhe inovacionet e mësimdhënies (në kurrikulë gjithashtu), janë investimet kryesore që ata i kryejnë si njerëz të përkushtuar për krijimin e mbështetjes së mjedisit gjithëpërfshirës për nxënësit me nevojë të veçanta.

QENDRA MËSIMORE GJITHËPËRFSHIRËSE E KOMUNITETIT

- Miqësore për fëmijët
 - Të gjithë nxënësit vlerësohen
 - I përgjigjet diversitetit
 - Fleksibile, relevante, e përballueshme financiarisht
 - Përfshirja e familjeve dhe komunitetit
 - Mësimdhënësit/menaxherët duke reflektuar diversitetin në komunitet, ata janë të përfshirë dhe të mirëseardhur
-

ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS

- Mësimi gjithëpërfshirës gjatë gjithë jetës: nga fëmijëria e hershme deri te mosha madhore
 - Gjithëpërfshirja, joformale, informale, alternative
 - Ekipet dhe qendrat burimore të qarkut
 - Përfshirja e prindërve, familjeve dhe komuniteteve
 - Përfshirja e aktivistëve dhe grupeve për të drejta
 - Grupet e nënshkrimit, grupet e shkrim leximit, qendrat
-

SHOQËRIA GJITHËPËRFSHIRËSE

- Dallimet vlerësohen dhe diskriminimi luftohet
- Pjesëmarrja aktive nga të gjithë
- Shpërndarja e barabartë e burimeve dhe qëndrueshmëria
- Drejtësia sociale, paqja
- Vlerësohet kultura tradicionale dhe njohuritë lokale
- Jetë dinjitoze dhe e barabartë për të gjithë
- Uji i pastër për pije dhe higjienë për të gjithë

8. Indeksi i gjithëpërfshirjes

*Indeksi për gjithëpërfshirje*¹¹ është një instrument për të udhëhequr institucionet shkollore përmes një procesi të zhvillimit gjithëpërfshirës. Bëhet fjalë për ndërtimin e komuniteteve mbështetëse dhe nxitjen e arritjeve të larta për të gjithë stafin dhe nxënësit.

Materialet fokusohen rreth një cikli të aktiviteteve që udhëheqin shkollat përmes fazave të përgatitjes, hulumtimit, zhvillimit, zbatimit dhe rishikimit.

- ➔ Materialet në Indeks ndihmojnë dhe mbështesin në identifikimin e rrugëve drejt arsimit gjithëpërfshirës, duke eksploruar tri dimensionet e ndërlidhura:
- ➔ Kulturat gjithëpërfshirëse - i referohen inkurajimit të atyre besimeve dhe sistemeve të vlerave që krijojnë një komunitet të sigurt, pranues, bashkëpunues dhe frymëzues për të gjithë pjesëmarrësit. Identifikuesi kryesor brenda organizatës është atmosfera e saj e pëlqyeshme dhe mikpritëse dhe prania e vlerave gjithëpërfshirëse. Njerëzit inkurajohen të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të bashkëpunojnë. Të gjithë (domethënë të gjithë akterët e përfshirë trajtohen me respekt).
- ➔ Politikat gjithëpërfshirëse - ofrojnë synime të qarta për promovimin e gjithëpërfshirjes në plane dhe dokumente të tjera të politikave. Ato fokusohen në politikat e pranimi dhe mundësisë së qasjes në organizatë (dhe objekte), në drejtim të punësimit të stafit dhe nxënësve, dhe në politikat që organizata ka zhvilluar për të organizuar mbështetjen për diversitetin dhe ndoshta edhe festimin e diversitetit.
- ➔ Praktikrat gjithëpërfshirëse -fokusohen në atë që faktikisht po ndodh në organizatë, në praktikrat që pasqyrojnë kulturat dhe politikat gjithëpërfshirëse, duke siguruar që aktivitetet të inkurajojnë pjesëmarrjen e të gjithë pjesëmarrësve.

Secili dimension ka një sërë treguesish me pyetjet të cilat mund të përdoren për të rishikuar dhe vlerësuar praktikrat aktuale që nxisin reflektimin kritik, diskutimin dhe debatin dhe ndihmojnë në zhvillimin e një kornize të përshtatshme për veprim. Theksi gjithashtu vihet në rëndësinë e zhvillimit të arsimit gjithëpërfshirës, të ndërlidhjes së veprimeve me vlerat gjithëpërfshirëse në procesin e planifikimit të zhvillimit.

¹¹ Zabeli, N. & Behluli, L. (2014). Indeksi për gjithëpërfshirje: Fakte dhe mendime: Marrë nga <https://kosovo.savethechildren.net/sites/kosovo.savethechildren.net/files/library/Index%20for%20Inclusion%20ENG.pdf>

Vlerat gjithëpërfshirëse të identifikuara në indeks dhe në bazë të indeksit janë si në vijim:

- | | | |
|------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------|
| 1. | Të shikohet çdo jetë dhe çdo vdekje si e barabartë në vlerë | <input type="checkbox"/> |
| 2. | Mbështetja e të gjithëve që të ndiejnë se i përkasin dikujt | <input type="checkbox"/> |
| 3. | Rritja e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe të rriturve në aktivitetet e mësimdhënies dhe mësimnxënies | <input type="checkbox"/> |
| 4. | Zhvillimi i marrëdhënieve dhe komuniteteve të shkollave lokale | <input type="checkbox"/> |
| 5. | Zvogëlimi i përjashtimit, diskriminimit, pengesave ndaj mësimdhënies dhe mësimnxënies. | <input type="checkbox"/> |
| 6. | Ristrukturimi i kulturave, politikave dhe praktikave për t'iu përgjigjur diversitetit në mënyra që i vlerësojnë të gjithë në mënyrë të barabartë | <input type="checkbox"/> |
| 7. | Lidhja e arsimit me realitetet lokale dhe globale | <input type="checkbox"/> |
| 8. | Mësimi nga zvogëlimi i pengesave për disa fëmijë për t'u sjell dobi më shumë fëmijëve | <input type="checkbox"/> |
| 9. | Shqyrtimi i dallimeve midis fëmijëve dhe midis të rriturve si burime për mësim. Njohja e të drejtës së fëmijëve për një arsim të cilësisë së lartë në lokalitetin e tyre | <input type="checkbox"/> |
| 10. | Përmirësimi i shkollave për stafin dhe prindërit/kujdestarët si dhe fëmijët | <input type="checkbox"/> |
| 11. | Theksimi i zhvillimit të komuniteteve dhe vlerave shkollore, si të arriturave | <input type="checkbox"/> |
| 12. | Nxitja e marrëdhënieve reciproke të qëndrueshme ndërmjet shkollave dhe komuniteteve përreth | <input type="checkbox"/> |
| 13. | Njohja se gjithëpërfshirja në arsim është një aspekt i gjithëpërfshirjes në shoqëri | <input type="checkbox"/> |

Indeksi për gjithëpërfshirje ka 5 faza të zhvillimit dhe secila fazë i ka specifikat të cilat duhet të përcjellën me shumë kujdes, sepse secila fazë është parakusht i rëndësishëm për të kaluar në fazën tjetër dhe në disa raste kur p.sh. në fazën e parë të punës nuk është punuar sa duhet në informimin e stafit dhe familjarizimin e punës me Indeks atëherë kjo ka vështirësuar fazën e dytë, tretë etj. Kjo varet shumë nga angazhimi i burimeve njerëzore brenda shkollës si p.sh. drejtori i shkollës si personi kyç i cili e mbështet dhe monitoron punën e grupit bashkërendues në të gjitha fazat e punës me Indeks.

Që nga viti 2007, MASH-i në bashkëpunim me Save the Children, ka përshtatur dhe ka filluar të përdorë “Indeksin për gjithëpërfshirje” në Kosovë. Indeksi është zbatuar në një numër të konsiderueshëm në institucione parashkollore dhe shkolla fillore e të mesme të ulëta. Në një hulumtim (Zabeli & Behluli, 2014) lidhur me efektet e zbatimit të Indeksit për gjithëpërfshirje në institucionet ku është zbatuar, rezultoi se përdorimi i këtij udhëzuesi ngriti kapacitetet e shkollave dhe kopshteve për të identifikuar dhe trajtuar problemet dhe çështjet të ndryshme me të cilat mund të ballafaqohen këto institucione në punën e tyre të përditshme. Kjo ka rëndësi sidomos në shfrytëzimin më të mirë të resurseve të shkollës dhe rritjes së bashkëpunimit me komunitetin me qëllim që shkolla të jetë një institucion gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët e komunitetit.

Gjithashtu, në një hulumtim të mëvonshëm (Zabeli & Gjelaj, 2020), lidhur me qëndrimet e mësimit dhe nxënësve dhe prindërve rreth ndikimit të Indeksit të gjithëpërfshirjes i përqëndruar në tri dimensioneve (Krijimi i kulturës gjithëpërfshirëse, Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse dhe Zbatimi i praktikave gjithëpërfshirëse) rezultoi se, në drejtim të të kuptuarit të gjithëpërfshirjes është bërë një punë e mirë ku të gjithë faktorët (mësimdhënësit, nxënësve dhe prindërve) e vlerësojnë lartë ndryshimin pozitiv të mendësisë për gjithëpërfshirjes. Hartimi i politikave gjithëpërfshirëse (dimensioni i dytë) konsiderohet të jetë në nivel mesatar. Shkollat nuk kanë hartuar gjithaq politika të mira të gjithëpërfshirjes të cilat do të reduktonin pengesat dhe vështirësitë për gjithëpërfshirje në shkollim.

Ndërsa, nivel më i ulët i përgjigjeve pozitive është Zbatimi i praktikave gjithëpërfshirëse si dimension i tretë. Përgjigjet janë më pak pozitive sa i përket sigurimit të mundësive për qasje fizike dhe të plotësisht të nevojave dhe afiniteteve të nxënësve (veçmas në lirinë për përcaktimin për lëndë zgjedhore (e shprehur nga nxënësit dhe mësimdhënësit).

Përqindje e ulët konstatohet në vlerësimin në mënyrë të barabartë nga ana e mësimit dhe në ofrimin e mundësive për zhvillimin e prirjeve apo talenteve të nxënësve (të shprehura veçmas nga qëndrimet e nxënësve).

Prindërit kanë qëndrime të larta rreth kulturës dhe hartimit të politikave gjithëpërfshirëse, por qëndrime në nivel relativisht të ultë rreth praktikave gjithëpërfshirëse.

Përgjigjet me nivel më të ulët janë veçmas në pjesëmarrjen në aktivitetet në klasë, në planifikimin e përbashkët me mësimdhënësit dhe në përfshirjen në planifikimin zhvillimor të shkollës (si nga nxënësit poashtu edhe nga prindërit).

AKTIVITETI 10

Debat i hapur:

A e keni zbatuar në shkollën tuaj Indeksin për gjithëpërfshirje? Nëse po, ndani me të tjerat përvojat, problemet dhe sfidat. Nëse jo, atëherë çfarë mund të bëni për të nisur me zbatimin e Indeksit për gjithëpërfshirje? Çfarë burimesh keni dhe çfarë u nevojitet?

9. Regjistrimi dhe barazia në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë

Statistikat vjetore të arsimit ofrohen dhe administrohen nga zyra për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) të MASH-it.¹⁶ Statistikat ofrojnë informata, p.sh. për numrin, për- katësinë gjinore dhe etnike të nxënësve dhe mësimdhënësve, si dhe institucioneve arsimore. Informatat bazë për shkollat grumbullohet nga drejtorët dhe nëpërmjet DKA-ve i sigurohen MASH-it.

Përkundër mbështetjes së vazhdueshme profesionale të ofruar nga GIZ CDBE, zyra e SMIA-s së MASH-it nuk ka kapacitete për të monitoruar në mënyrë adekuate sistemin e SMIA-s për grumbullimin dhe raportimin e të dhënave. Sa i përket aspekteve të gjithëpërfshirjes, ka pasur gjithmonë sfida në mbledhjen e të dhënave të besueshme të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, fëmijëve jashtë shkollës dhe fëmijëve që kanë braktisur shkollën në sistemin arsimor. Të dhënat vjetore të SMIA-s publikohen nga MASH-i, në versionin e shtypur dhe elektronik. Të gjitha botimet SMIA-s mund të jenë të qasshme online në <http://MASH-smia.net>.

Vështirësitë në grumbullimin e të dhënave të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore janë për shkak të mungesës së mekanizmave në nivel shkolle për të mbledhur të dhënat, njohuritë dhe aftësitë për të identifikuar nevojat e veçanta arsimore. Në disa raste nxënësit me syze janë identifikuar si nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Aktualisht MASH-i me mbështetjen e Save the Children është duke përgatitur një formulë për identifikimin dhe grumbullimin e të dhënave të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla.

Për më tepër, krijimi i raporteve të të dhënave në lidhje me braktisjen e shkollës dhe mosvijimin në shkollë mbetet një sfidë pasi që mungojnë të dhënat dhe ato që janë në dispozicion janë shumë të pasigurta. Një sfidë tjetër është se koncepti “fëmijët jashtë shkollës” as nuk është madje i përkufizuar në dokumentet e politikave të arsimit në Kosovë. Disa nga problemet kryesore me grumbullimin e të dhënave të braktisjeve dhe mosvijueshmërisë në shkollë të paraqitura në këto raporte janë:

- ➔ Mungesa e mekanizmit të mbledhjes së të dhënave dhe llogaridhënies për ata që janë përgjegjës për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave për nxënësit që braktisin shkollën;
- ➔ Problemet me përputhjen e të dhënave të mbledhura në shkolla krahasuar me departamentet e arsimit në nivel lokal;
- ➔ Mungesa e mbledhjes së të dhënave për arsyet e braktisjes së shkollës;
- ➔ Mungesa e mundësisë për ndarjen e të dhënave ekzistuese sipas gjinisë dhe përkatësisë etnike ose komunitetit;
- ➔ Mungesa e sistemit për identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave për fëmijët që nuk kanë qenë kurrë në shkollë, dhe;
- ➔ Mungesa e sistemit të fuqishëm për menaxhimin e mungesës së zgjatur të nxënësve.

PIKAT KONTROLLUESE:

Çfarë mund të bëjnë drejtorët e shkollave dhe DKA-të për të përmirësuar gjithëpërfshirjen në nivelin parashkollor?

- 1 Për të përmirësuar kushtet për arsimin parashkollor cilësor për të gjithë dhe veçanërisht përfëmijët në gjendje të disfavorshme, me vonesa në zhvillim dhe dwttime tw llojeve tw ndryshme;
- 2 Për të ndërtuar dhe krijuar më shumë institucione parashkollore për të siguruar qasje për të gjithë fëmijët;
- 3 Për të rritur ndërgjegjësimin në mesin e prindërve dhe komuniteteve për rëndësinë e edukimit në fëmijëri të hershme;
- 4 Për të lehtësuar kalimin e fëmijëve ndërmjet familjes dhe nivelit parashkollor, si dhe ndërmjet-nivelit parashkollor dhe nivelit parafillor;
- 5 Për të përmirësuar ekuilibrin gjinor ndërmjet stafit.

9.1. Arsimimi i nxënësve nga komunitetet pakicë

Në Kosovë, nxënësit nga komuniteti serb regjistrohen në një sistem paralel të shkollave, të cilat mësojnë në gjuhën serbe, ndjekin programin mësimor të Serbisë dhe përdorin tekstat shkollore serbe të prodhuara dhe të aprovuara nga Ministria e Arsimit e Serbisë. Struktura e kurrikulës serbe është krejtësisht ndryshe nga kurrikula e Kosovës. Situata nuk po e lehtëson gjithëpërfshirjen e nxënësve nga komunitetet serbe në Kosovë.

Për të përmbushur ligjin dhe të drejtën e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për arsim në gjuhën e tyre, komunat kanë krijuar klasa ose shkolla të veçanta që veprojnë në gjuhët e komuniteteve. Nxënësit boshnjakë shpesh janë të integruar në klasat shqiptare, por në shumë komuna ata kanë klasa dhe shkolla të tyre. Nxënësit kroatë regjistrohen në klasat e tyre me mësimdhënësit e tyre kroatë. Arsimi për komunitetin turk ofrohet në shkollat ose klasat turke. Nxënësit goran, për shkak të numrit të tyre të vogël, përgjithësisht integrohen në sistemin arsimor të Kosovës, qoftë në gjuhën boshnjake ku këto klasa ekzistojnë ose më rrallë në gjuhën shqipe. Shumica e goranëve në komunën e Dragashit preferojnë t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollat e udhëhequra nga Serbia, ku mësimi është në gjuhën serbe, gjë që siguron mundësi më të mëdha për t'u regjistruar në universitetet serbe.

Nxënësit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RAE) kryesisht marrin pjesë në shkollat në gjuhën shqipe, por gjithashtu në klasa ose në shkolla me gjuhë mësimore turke, boshnjake dhe serbe. Shumica e ashkalive dhe egjiptianëve në Kosovë e konsiderojnë gjuhën shqipe si gjuhën e tyre amtare. Anëtarët e komunitetit rom në përgjithësi flasin romanisht dhe/ose serbisht dhe një përqindje e vogël flet shqip. Gjuha e përdorur në shkolla mbetet një sfidë për fëmijët që kanë gjuhën rome si gjuhë amtare pasi që nuk ka shkolla në të cilat gjuha rome përdoren si gjuhë mësimore ose

ku është e mundur të mësohet gjuha rome. Pavarësisht nga e drejta për qasje të barabartë në arsim për të gjithë në Kosovë, fëmijët e komuniteteve RAE kanë mbetur më të prekurit nga braktisja e sistemit arsimor.

AKTIVITETI 11

Diskutoni në dyshe: Cili është niveli i braktisjes së shkollës dhe mosvijimit në shkollën tuaj?

Cilët janë shkaktarët?

Çfarë mund të bëni për të parandaluar braktisjen?

Prezentoni para të tjerëve.

9.2. Parandalimi i braktisjeve të shkollës dhe mosvijimit në shkollë

AKTIVITETI 12

Diskutoni në grup rreth nxënësve të komunitetit pakicë. A keni në shkollën tuaj? Si qëndron çështja e gjithëpërfshirjes së tyre?

Me Ligjin për Arsimin Parauniversitar (neni 15), vijueshmëria e nxënësve në arsimin e detyrueshëm është përgjegjësi e prindërve dhe do të jetë shkelje për prindin e një fëmije të moshës për shkollë të detyrueshme, qoftë:

- ➔ Për shkak se dështon ta regjistrojë fëmijën në shkollë që është ose shkollë komunale, institucion trajnimi, shkollë speciale ose shkollë private e licencuar, e përshtatshme për moshën dhe nivelin e studimit të fëmijës ose për shkak se nuk arrin të bëjë masa alternative për edukimin e fëmijës, të cilat janë aprovuar nga Ministria.
- ➔ Për shkak se dështon pa shkak të arsyeshëm, të përcaktuar si sëmundje ose ndonjë shkak tjetër i pashmangshëm, për të siguruar ndjekjen e rregullt të tij në institucionin arsimor në kohën e caktuar nga këshilli drejtues për fillimin e vijimit të mësimin.

Për të promovuar pjesëmarrjen dhe zvogëluar braktisjen, komuna do të organizojë transport të sigurt dhe efikas për nxënësit në arsimin e detyrueshëm për të vijuar shkollën. Ligji gjithashtu përcakton se Ministria do të përgatis dhe nxjerrë udhëzime për të ndihmuar komunat, institucionet arsimore dhe trajnuese për t'u marrë në mënyrë efektive me braktisjen dhe të sigurojë vijueshmërinë në shkollë. Prandaj, MASH-i ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ (19/2012) mbi Themelimin dhe Zbatimin e Ekipeve për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mos-regjistrimit (PRTAN) në Arsimin e Detyrueshëm. Roli i PRTAN-it në nivel shkollor dhe komunal është diskutuar në Modulin mbi Komunikimin dhe Bashkëpunimin.

Një studim mbi “fëmijët jashtë shkollës në Kosovë” të realizuar nga KPI dhe UNICEF (2014)¹⁷, identifikoi tre karakteristika të përbashkëta individuale për fëmijët ose adoleshentët që ishin jashtë shkollës ose që e kishin braktisur atë: ata kanë prirje të jenë fëmijë nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, ata u regjistruan në shkollë vonë dhe morën nota të ulëta të suksesit. Sipas rezultateve të studimit, ekipet PRTAN nuk janë të themeluara në të gjitha komunat, e as në të gjitha shkollat, dhe kur janë themeluar nuk kanë pasur ndonjë plan të veprimit se si të parandalojnë dhe të përgjigjen ndaj braktisjes apo mosregjistrimit.

Një tjetër studim u krye nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE, 2012). Gjetjet kyçe të studimit treguan një mungesë të konsiderueshme të të dhënave të besueshme zyrtare në lidhje me braktisjen e shkollës, kryesisht për shkak të mekanizmave joadekuate të monitorimit nga shkollat dhe institucionet e tjera përgjegjëse. Ky studim ofroi disa rekomandime kryesore për palët e përfshira:

Për MASHT-in:

Sigurimi i zbatimit të detyrimeve ligjore të institucioneve lokale të arsimit për të mbledhur të dhëna të sakta cilësore dhe sasore afatgjata mbi braktisjen e shkollës, të ndara sipas gjinisë, komunitetit dhe çfarëdo kategorie tjetër relevante.

Të kërkojë përdorimin e një sistemi për menaxhimin e informatave në arsim në të gjitha shkollat e kurrikulës së Kosovës, me standarde të qarta dhe të drejtpërdrejta në lidhje me mënyrën se si shkollat duhet të ndjekin nxënësit që kanë braktisur shkollën. Të sigurojë se transferet ndërmjet shkollave dhe arsyt e tjera për nxënësit që dalin nga shkolla të jenë të regjistruara në mënyrë të saktë dhe të duhur në të gjitha rastet.

Të sigurojë udhëzime për Drejtoritë Komunale të Arsimit mbi mënyrën e zbatimit të kërkesave për grumbullimin e të dhënave dhe elementeve të tjerë të Planit të Veprimit kundër braktisjes së shkollës.

Për DKA-të

Të punohet ngushtë me të gjithë drejtorët e shkollave për të monitoruar rregullisht shkallën e braktisjes së shkollës dhe shkallën e vijueshmërisë dhe të bëjë raportimin sistematik tek MASHT-i.

Të bashkëpunojë me MASHT-in dhe me të gjithë drejtorët e shkollave për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të zbatuar udhëzimet për grumbullimin e të dhënave në Planin e Veprimit kundër Braktisjes së Shkollës.

Të hulumtojë në mënyrë proaktive dhe të rregullojë rastet e mos-regjistrimit në shkollë, duke përfshirë ndjekjen e vijueshmërisë së fëmijëve të moshës shkollore në komunat përkatëse.

Për drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit

Të monitorojë në mënyrë proaktive fenomenin dhe arsytet për mos-vijueshmëri dhe braktisjen në baza ditore, mujore dhe vjetore – si dhe brenda ciklit të vitit shkollore – dhe t'i raportojë këto të gjetura Drejtorisë Komunale për Arsim çdo gjysmëvjetor me të dhëna të ndara sipas gjinisë, komunitetit dhe çdo kategorie tjetër relevante.

Të kërkojë në mënyrë proaktive nxënësit që mungojnë nga shkolla dhe prindërit e tyre për të identifikuar faktorët që qëndrojnë prapa mungesës së fëmijës nga shkolla dhe për të inkurajuar vijueshmërinë.

Për organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare

T'i inkurajojë dhe përkrahi institucionet e Kosovës për të monitoruar dhe luftuar menjëherë dhe në mënyrë efektive braktisjen e shkollës, dhe për të përmirësuar kapacitetet e tyre për të ndjekur dhe për t'u përgjigjur boshllëqeve të vijueshmërisë ndërmjet segmenteve të ndryshme të popullsisë.

9.1. Promovimi i barazisë gjinore në arsim

Çështjet gjinore në arsim në Kosovës janë të përcaktuara në dokumentet vijuese politike/ligjore (por duke u mos kufizuar vetëm në këto):

- ➔ Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017 -2021
- ➔ Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar (2011) Ligji nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore (2015)
- ➔ Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi (2015)

Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2011-2016 (2011) promovon gjithëpërfshirjen si një koncept gjithëpërfshirës, i cili përfshin pjesëmarrjen e plotë të të gjithë njerëzve, pa marrë parasysh dallimeve të tyre sociale si gjinia, përkatësia etnike, klasa sociale dhe aftësia e kufizuar në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore.

Një nga qëllimet e Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar (2011) është përgatitja e nxënësit për një jetë të përgjegjshme në frymën e mirëkuptimit, paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësisë me anëtarët e të gjithë komuniteteve në Republikën e Kosovës. Në planifikimin, menaxhimin dhe realizimin e sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat dhe institucionet arsimore dhe/ose të trajnimit duhet të kenë parasysh normat e pranuar ndërkombëtarisht të Edukimit për të Gjithë (EpGj), të drejtat e fëmijës, mbrojtjen e grupeve të cënueshme brenda shoqërisë dhe promovimin e barazisë gjinore.

Qëllimi i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi (2015) është krijimi i një kornize të përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë, ose në lidhje me shumë çështje të tjera, përfshirë seksin, gjininë, identitetin gjinor dhe orientimin seksual, Në mënyrë që të zbatohet parimi i trajtimit të barabartë.

Qëllimi i Ligjit për Barazi Gjinore (2015) është të garantojë, të mbrojë dhe të promovojë barazinë midis gjinive si një vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë. Ajo përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për të siguruar dhe mbrojtur të drejtat e barabarta të burrave dhe grave, dhe përcakton institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

Neni 20 i Ligjit për barazinë gjinore merret me ndalimin e diskriminimit gjinor dhe trajtimit të pabarabartë duke deklaruar se është i ndaluar diskriminimi në bazë të gjinisë brenda institucioneve arsimore në të gjitha nivelet, duke përfshirë qasjen në arsim, procesin e pranimit, qasjen në shërbime, lehtësira dhe përfitimet si bursa, rezultatet e vlerësimit, marrjen e gradave dhe titujve shkencorë, qasje në trajnime profesionale, arsim, sport dhe fusha të tjera.

Sipas Ligjit për barazi gjinore, veprimet e mëposhtme përbëjnë diskriminim në bazë të gjinisë:

- ➔ Çdo kufizim i bazuar në gjini, ose pengesa në krijimin e mjediseve të nevojshme, për t'u arsimuar në institucione publike ose private që ofrojnë arsimim ose kualifikime të tjera dhe shërbime trajnuese;
- ➔ Mundësi të ndryshme për burra dhe gra në përzgjedhjen e një studimi, trajnimit ose diplomimit të posaçëm, dhe sa i përket kohëzgjatjes së klasave përveç nëse justifikohet nga një qëllim legjitim dhe mjetet për arritjen e këtij qëllimi janë të përshtatshme dhe të nevojshme.

Ligji mbi barazinë gjinore zbatohet për burra, gra dhe persona që kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor ose përcaktimit të seksit, dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë në fushat publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë arsimin.

AKTIVITETI 13

Shpjegoni se si funksionon ekipi i PRTAN-it në shkollën tuaj.

Diskutoni mësimin për fëmijët "jashtë shkollës". Si zbatohen ato në shkollën tuaj dhe në komunën tuaj?

Si do të siguronit që të zbatoni rekomandimet nga studimi i OBEZh-it në shkollën, komunën tuaj dhe në tërë sistemin?

Ndani me grupin gjendjen në lidhje me barazinë gjinore në shkollën tuaj.

Ndani disa të dhëna që tregojnë barazinë gjinore në pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme shkollore.



10. Qasjet e ndryshme ndaj arsimit për fëmijët me nevoja të veçanta

NDARJA në të cilin fëmijët me aftësi të kufizuara vendosen në shkolla speciale ose në njësi të veçanta brenda shkollave që janë të dizajnuara për t'iu përgjigjur dëmtimeve të veçanta ose aftësive të kufizuara;

INTEGRIMI ku nxënësi me nevoja të veçanta arsimohet pjesërisht në një program të veçantë arsimor, por në masën maksimale të mundshme arsimohet në programin e arsimit të përgjithshëm;

MJEDISET GJITHËPËRFSHIRËSE janë të dizajnuara për të siguruar një mjedis edukimi në të cilin të gjithë fëmijët mund të jenë sa më të përfshirë dhe të pavarur që të jetë e mundur. Prandaj, mësimdhënësit kanë nevojë për trajnim specifik parashërbimit dhe gjatë shërbimit, në mënyrë që t'iu përgjigjen nevojave dhe aftësive të veçanta të nxënësve.



Sfidat me të cilat janë përballur shkollat e Kosovës




Figura: Shpjegimi i dallimeve ndërmjet arsimit special, të integruar dhe gjithëpërfshirës. Vizatimi origjinal nga S. Stubbs, përshtatur nga K. Chesterton

AKTIVITETI 14

Diskutoni në grup, cilat mendoni nga qasjet e paraqitura më lart, përfaqëson shkolla juaj? Çfarë mund të bëni ju në mënyrë që shkolla t'i përshtatet nxënësit dhe jo nxënësi shkollës?

10.1. Trajnimi dhe zhvillimi i mësimitdhënësve para shërbimit dhe gjatë shërbimit

Edukimi i mësimitdhënësve dhe qëndrimet që ata mbajnë në lidhje me gjithëpërfshirjen janë më të rëndësishmet për të bërë punën arsimore gjithëpërfshirëse. Të gjithë mësimitdhënësit duhet të trajnohen dhe të pajisen me qëndrimet, vlerat dhe aftësitë e duhura për të menaxhuar klasën gjithëpërfshirëse dhe për t'i mësuar nxënësit me nevoja të ndryshme.

Trajnimi i mësimitdhënësve para dhe gjatë shërbimit duhet të synojë të përgatisë mësimitdhënësit e klasës së rregullt për arsimin gjithëpërfshirës. Trajnimi i mësimitdhënësve duhet të ofrojë njohuri që e

bën të qartë teorinë dhe arsyetimin për arsimin gjithëpërfshirës, si dhe përvojat praktike në zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës duke përfshirë diferencimet në lidhje me strategjitë, përmbajtjen, materialin dhe vlerësimin.

Trajnimi i mësimdhënësve duhet të përgatisë mësimdhënësit për përdorimin e vlerësimit të vazhdueshëm si një mjet për punën e tyre. Ai duhet t'i udhëzojë ata në vendosjen e qëllimeve të qarta dhe konkrete të nxënësve dhe të përdorin rezultatet e vlerësimit si bazë për planifikimin e përvojave të nxënësve në të ardhmen për të gjithë nxënësit. Në veçanti, trajnimi duhet t'u sigurojë mësimdhënësve informata dhe mjete për të zhvilluar në mënyrë efektive marrëdhëniet midis një Plani Individual për Arsim dhe vlerësimit të vazhdueshëm.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i nevojave për mbështetje të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore duhet të bëhet sa më herët që të jetë e mundur në karrierën e tyre në shkollë. Në mënyrë që kjo të realizohet, mësimdhënësit duhet të trajnohen për të vëzhguar dhe për të kryer vlerësimet e shqyrtimit të nxënësve në klasat e tyre, për të përdorur mjetet e shqyrtimit dhe për të interpretuar rezultatet e vlerësimit. Ata duhet të pajisen me materiale udhëzuese për t'i ndihmuar ata në identifikimin e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore.

Trajnimi i mësimdhënësve parashërbimit në Fakultetin e Edukimit në nivelin e Diplomës Bachelor duke përfshirë trajnimin për mësimdhënësit e shkollave parashkollore dhe shkollave fillore ofron drejtimin që lidhet me nevojat e veçanta/arsimin gjithëpërfshirës. Drejtimet ofrohen në nivelin Bachelor dhe Master. Përveç kësaj, FiE ofron një program Master për arsimin gjithëpërfshirës. Grupi i synuar përfshin edukatorë, mësimdhënës klasor dhe pedagogë.

Studentët e lëndëve mësimore nga fakultetet e tjera kanë mbetur pa ndonjë trajnim për nevoja të veçanta/arsim gjithëpërfshirës. Në tetor 2015 do të ketë ndryshime vijuese në programet e trajnimit të mësimdhënësve:

- ➔ Të gjithë mësimdhënësit lëndor do të kenë trajnimin e tyre specifik në fakultetin e tyre, por në mënyrë që të bëhen mësimdhënës ata duhet të marrin diplomën Master në Arsim në Fakultetin e Edukimit;
- ➔ Edukatorët e fëmijërisë së hershme duhet të përfundojnë studimet e tyre universitare bachelor.

Drejtimet ekzistuese janë të përqendruara kryesisht në nevoja të veçanta arsimore dhe nevojitet një lëvizje nga nevojat e veçanta në qasjen gjithëpërfshirëse. Drejtimet për arsimin gjithëpërfshirës nevojiten për të kuptuar se çka është arsimi gjithëpërfshirës dhe duhet siguar që qasja gjithëpërfshirëse e arsimit të futet në të gjitha trajnimet e mësimdhënësve, duke përfshirë trajnimin e mësimdhënësve lëndor, në mënyrë që të gjithë mësimdhënësit të pajisen me njohuri dhe shkathtësi se si të menaxhojnë klasën gjithëpërfshirëse.

Fakulteti i Edukimit ka qenë duke ofruar trajnime në shërbim për të aftësuar mësimdhënësit me diplomën Bachelor. Si pjesë e këtyre studimeve, Fakulteti i Edukimit ka qenë duke ofruar kursin për arsimin gjithëpërfshirës. FE ka zhvilluar programin Master për mësimdhënësit e AAP që ka filluar në 2016 - 2017.

10.1.1. Nevojiten trajnimet e mësimdhënësve

Trajnimi i stafit mbështetës: Sistemi i arsimit gjithëpërfshirës ka nevojë për stafin mbështetës, siç janë mësimdhënësit mbështetës, mësimdhënësit jo të rregullt dhe asistentët e shkollave. Trajnimi i tyre mund të ofrohet si trajnim gjatë dhe para shërbimit në FE. Trajnimet të avancuara në shërbim janë të nevojshme për mësimdhënësit e qendrave burimore.

Trajnimi i zhvillimit profesional: Programi i trajnimit për zhvillim profesional (ZhP) mbi arsimin gjithëpërfshirës, që u zbatua nga projektet finlandeze në vitet 2000-2012, mund të shërbejë si bazë për zhvillimin e programeve të trajnimit në shërbim. Gjatë viteve 2000 - 2012 janë trajnuar pesë grupe nga rreth 35 profesionistë të arsimit në secilin grup. Secili praktikant mori pjesë në kursin e zhvillimit profesional për pesë ditë në muaj për një vjet e gjysmë. Modulet e trajnimit të zhvillimit profesional mund të ofrohen edhe si kurse të pavarura të trajnimit të shkurtër.

Trajnimi i stafit të trajnimit të mësimdhënësve: Me qëllim të ofrimit të programeve efektive, duhet t'i kushtohet vëmendje edhe kualifikimeve dhe aftësive të edukatorëve mësimdhënës në fushën e arsimit gjithëpërfshirës.

Lidhja e trajnimit të mësimdhënësve me shkollat: Është shumë e rëndësishme që studentët mësimdhënës të njihen me metodat e hulumtimit në arsim. Ata duhet të mësojnë se si t'i mbledhin dhe analizojnë të dhënat empirike nga terreni. Si një shembull i mirë i këtij lloji të praktikës është detyra e mëposhtme për studentët e nivelit bachelorr në Fakultetin e Edukimit Prishtinë.

Diskutoni në grupe se si idetë vijuese do të mund t'a përmirësonin trajnimin e mësimdhënësve në shkollën tuaj?

- ➔ Ofrimi i mundësive dhe trajnimeve për trajnerët e mësimdhënësve (duke përfshirë trajnuesit e mësimdhënësve lëndor) që të njihen dhe të përfshijnë qasjen gjithëpërfshirëse të arsimit në të gjitha trajnimet;
- ➔ Riorientimi dhe harmonizimi i programeve të trajnimit të mësimdhënësve (si para shërbimit ashtu edhe në shërbim) me qasjen e arsimit gjithëpërfshirës për të ndërtuar kapacitete pedagogjike të mësimdhënësve për të plotësuar nevojat e ndryshme, dhe për të menaxhuar klasën gjithëpërfshirëse;
- ➔ Sigurimi i kurseve të trajnimit mbi parimet dhe praktikatat e arsimit gjithëpërfshirës për të gjithë profesionistët e arsimit (edukatorët e fëmijërisë së hershme, mësimdhënësit klasor dhe lëndor);
- ➔ Të sigurohet që qasja e arsimit gjithëpërfshirës të integrohet në të gjitha programet e trajnimit lëndor për trajnuesit e mësimdhënësve;
- ➔ Sigurimi i trajnimit për dallimet në kurrikulë, vlerësimin dhe shqyrtimin e kurrikulës në klasën gjithëpërfshirëse;
- ➔ Sigurimi i trajnimit për përdorimin e PIA-ve;
- ➔ Të trajnohen më shumë edukatorë dhe mësimdhënës nga komunitetet pakicë; Përgatitja e programeve të trajnimit për mësimdhënësit që të punojnë si mësimdhënës mbështetës;
- ➔ Përgatitja e programit trajnues për asistentët e mësimdhënës.
- ➔ Bashkëpunimi me komunat dhe shkollat në mënyrë që të gjeni ofrimin e praktikave të studentëve mësimdhënës në shkolla.

11. Sfidat për diversitet dhe gjithëpërfshirje në shkollat e Kosovës

Programi i Binjakëzimit i BE-së për mbështetjen zbatimit të PSAK 2011-2016 ka hartuar një Udhërrëfyes për Diversitetin dhe Gjithëpërfshirjen në Arsimin Parauniversitar në Kosovë, në vitin 2016. Udhërrëfyesi thekson rezultatet e shumta pozitive të arritura në Kosovë duke zhvilluar infrastrukturën ligjore për arsimin gjithëpërfshirës, por sfidat mbesin në përkthimin e vizionit të gjithëpërfshirjes të përcaktuar në ligj dhe dokumente të tjera arsimore, megjithatë, ajo identifikon sfida të shumta për të zbatuar praktikën pedagogjike në nivel komunal dhe shkollor.

Pika fillestare për zhvillimin e gjithëpërfshirjes në arsim është identifikimi i të gjitha barrierave në mjedis, qëndrimeve dhe për mënyrën se si shkolla është e organizuar dhe si funksionon. Analiza e gjendjes e bërë në vitin 2014 nga Programi i Binjakëzimit në 61 shkolla pilot në vitin 2014 tregoi se ka shumë sfida me të cilat përballen shkollat në fillimin e zbatimit të KKK-së dhe gjithëpërfshirjes si një nga primet kryesore të saj. Këto sfida, siç paraqiten nga Programi i Binjakëzimit i BE-s, janë përshkruar më poshtë.

Qëndrimet, vetëdijesimi dhe njohuritë

- 1) Mungesa e njohurive dhe trajnimit për arsimin gjithëpërfshirës. Drejtorët dhe mësuesit nuk janë të njohur me konceptin e gjithëpërfshirjes. Koncepti "nxënës me nevoja të veçanta arsimore" u referohet nxënësve me dëmtime fizike, vizuale, dëgjimore dhe intelektuale. Trajnimi është i nevojshëm në mënyrë që drejtorët e shkollave të menaxhojnë shkollën gjithëpërfshirëse dhe mësuesit të menaxhojnë klasat gjithëpërfshirëse.
- 2) Qëndrimet ndaj diversitetit në shkolla dhe në komunitetet përreth duket të jenë ende kryesisht negative. Disa nga drejtorët e shkollave ku nuk ka ndonjë nxënës nga komunitetet pakicë paraqiteshin krenarë se janë shkollë kulturore homogjene, ose veçanërisht në shkollat e mesme të larta që nuk kishin nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Si një shembull i qëndrimeve negative në komunitet, një nga shkollat pilot donte të krijonte një klasë të bashkangjitur në shkollë për t'i akomoduar nxënësit me aftësi të kufizuara në shkollë, por për shkak se anëtarët e komunitetit nuk dëshironin të kishin "kategori të tillë të fëmijëve" në shkollë, nuk u krijua asnjë klasë e bashkangjitur dhe fëmijët me aftësi të kufizuara mbetën pa qasje në shkollë.

Qasja

3) Nxënësit e komuniteteve pakicë janë në shumicën e shkollave të integruar në klasat e rregullta. Gjuha e mësimdhënies dhe mësimnxënies është kryesisht gjuha shqipe, e cila po shkakton vështirësi në mësim për nxënësit, veçanërisht nga komuniteti rom, ku vështirësitë e të nxënësve lehtë çojnë në braktisje. Mësimdhënësit nuk janë të trajnuar për të plotësuar diversitetin kulturor në klasa, dhe nxënësit e komuniteteve pakicë në shumicën e shkollave nuk marrin ndonjë mbështetje shtesë. Në disa shkolla ekzistojnë OJQ-të lokale që ofrojnë mbështetje veçanërisht për nxënësit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

4) Nxënësit me arsim special: Numri i nxënësve me aftësi të kufizuara në 61 pilot shkolla është vetëm 0,4% e regjistrimit gjithsej, dhe shumica e këtyre nxënësve janë të ndarë në klasa të bashkangjitura. Numri i nxënësve me vështirësi në mësim, siç janë vështirësitë në lexim, shkrim dhe matematikë, nuk dihet. Këta nxënës nuk janë identifikuar dhe nuk marrin ndonjë mbështetje shtesë.

5) Qasja në shkollë: Numri i vogël i nxënësve me nevoja të veçanta arsimore krahasuar me vendet e tjera (në Finlandë rreth 22% e nxënësve marrin mbështetje të posaçme arsimore) tregon se ose nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk janë të identifikuar në shkolla ose fëmijët me nevoja të veçanta mungojnë nga shkollat. Numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara që nuk kanë qasje në shkollë është i panjohur.

Identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe mbështetje arsimore

6) Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore: Identifikimi dhe mbështetja e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore çalon në shumicën e shkollave. Shkollat nuk kanë asnjë mjet për të identifikuar nevojat e veçanta arsimore dhe për të përgatitur programe dhe plane për mbështetjen individuale. Mësimdhënësve u mungojnë njohuritë, aftësitë dhe mbështetja për të identifikuar dhe mbështetur nxënësit me nevoja të ndryshme.

7) Ekipet Komunale për Vlerësim janë themeluar rishtazi dhe ende nuk janë funksionale, përveç komunave të Ferizajt dhe Gjilanit. Shkollat nuk janë të vetëdijshme për ekzistimin dhe disponueshmërinë e shërbimeve të ekipeve vlerësuese.

8) Qasja në kurrikul: Diferencimet e kurrikulës nuk janë në përdorim në shkolla. Të gjithë nxënësit në klasë po ndjekin të njëjtat përmbajtje dhe strategji të kurrikulës dhe kështu, nxënësit me nevoja të veçanta arsimore nuk kanë qasje të duhur në kurrikulë dhe mësim.

9) Planet e Individualizuara të Arsimit (PIA): PIA janë në përdorim vetëm për nxënësit në klasat e bashkangjitura ose në shkollat speciale. Mësimdhënësit në shkollat e rregullta nuk janë të trajnuar ose të njoftuar me përdorimin e PIA-ve.

10) Vlerësimi: Për shkak të mungesës dhe përdorimit të PIA-ve dhe strategjive të vlerësimit alternativ, nxënësit me NVA vlerësohen në mënyrë të barabartë me të gjithë të tjerët pa u kushtuar vëmendje nevojave të tyre individuale. Kjo shkakton përsëritjen e klasës dhe çon lehtësisht te braktisja.

11) Sistemet e mbështetjes mungojnë: Sistemet mbështetëse veçanërisht për nxënësit me nevoja të veçanta arsimore janë të paorganizuar. Asistentët e shkollës, mësimdhënësit mbështetës, pedagogët, psikologët dhe profesionistët e kujdesit shëndetësor, me disa përjashtime mungojnë nga shkollat. Një nga pilot shkollat ka krijuar një sistem brenda shkollës për të ofruar mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta dhe mësimdhënësit e tyre. Mbështetja e jashtme mungon nga shumica e shkollave. Mësimdhënësit jo të rregullt nga qendrat burimore nuk kanë vizituar shkollat, dhe ekipet shumë-profesionale janë funksionale vetëm në dy komuna.

Mjedisi fizik

12) Ndërtesat shkollore nuk janë të arritshme për nxënësit me nevoja të veçanta. Shumë shkolla kanë ndërtuar shtigje të pjerrëta për nxënësit me vështirësi fizike, por përndryshe nuk është bërë shumë në shkolla për të krijuar mjedisin e mësimit pa pengesa për të gjithë.

13) Infrastruktura dhe mirëmbajtja e shkollave: Ndërtesat shkollore shkaktojnë shumë probleme: shumica e buxhetit të shkollës shpenzohet për ngrohje, kulmet rrjedhin, klasa është e nxehtë në verë dhe e ftohtë në dimër, ka probleme me lagështi, dyshemetë në disa shkolla janë konsumuar dhe madje edhe janë të rrezikshme. Gypat e ujit dhe të ujërave të zeza mungojnë në një shkollë. Niveli i dobët higjienik i tualeteve dhe i tualetit turk shkakton që tualetet të jenë të paarritshme për nxënësit me dëmtime fizike dhe pamore.

14) Hapësira shkollore: Shkollat e mbingarkuara dhe puna me dy ndërrime pengon funksionimin e shkollave. Mungesa e hapësirës është një problem i zakonshëm për shkollat edhe pse shkollat kryesisht punojnë me dy ndërrime. Puna me dy ndërrime po e bën sfiduese organizimin e klasave, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e shkollës, dhe zbatimin e KKK-së.

15) Klasat e mbingarkuara kanë efekte të drejtpërdrejta në metodat e mësimit dhe në procesin mësimor dhe në rezultatet. Në qytetet më të mëdha ka shkolla fillore dhe të mesme të ulëta me mesatare mbi 30 nxënës dhe shkollat e mesme deri në 48 nxënës në klasë.

16) Klasat: Klasa tipike përmban banka për dy nxënës dhe karrige, të cilat tradicionalisht janë të vendosura në rresht. Në shumë shkolla bankat dhe karriget janë vjetruar. Muret janë kryesisht bosh dhe ka shumë jehonë në klasë, si dhe korridorët e shkollave janë kryesisht të mëdha. Shumica e klasave janë me dritare të mëdha dhe pa perde, gjë që i bën klasat shumë të nxehta gjatë verës. Dërrasat e zeza shpesh janë në gjendje të keqe ose janë punuar prej materiali që nuk mund të përdoret siç duhet.

Mësimdhënia dhe Mësimnxënia

17) Materialet e mësimdhënies dhe mësimnxënies: KKK-ja thekson këndvështrimin me nxënësin dhe kompetencat në qendër të vëmendjes të cilat kërkojnë që materialet dhe burimet për mësimdhënie dhe mësimnxënie të motivojnë nxënësit dhe të stimulojnë përparimin e tyre në mënyrë kuptimplote. Tekstet konsiderohen si burime të vlefshme të të nxënësve, por qasja e nxënësve në informata nuk duhet të kufizohet vetëm në tekstet shkollore (KKK, f.56). Mësimdhënësit duhet të përdorin shumëllojshmëri të burimeve për mësimnxënie si: tekstet alternative të lëndëve brenda një fushe të kurrikulës; materialet e krijuara nga vetë mësimdhënësit; burime të gatshme nga faqet e internetit në dispozicion; platformat e mësimit elektronik; e-biblioteka (biblioteka elektronike); dhe burime të ndryshme nga jeta e përditshme.

Aktualisht madje edhe materialet bazë të mësimdhënies dhe mësimnxënies kryesisht mungojnë ose janë të vjetruara në shumicën e klasave. Mungesa e pajisjeve dhe e furnizimeve ndikon negativisht në strategjitë e përdorura për mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe rrjedhimisht rezultatet e të nxënësve. Për studentët me aftësi të kufizuara nuk ka pajisje ndihmëse të disponueshme.

18) Strategjitë e kufizuara të mësimdhënies: Strategjitë e mësimdhënies në përdorim janë të kufizuara për shkak të mungesës së hapësirës, materialeve, pajisjeve, furnizimeve dhe trajnimit.

11.1. Si të arrihet progres në gjithëpërfshirje në shkollat e Kosovës?

Është përgjegjësi e sistemit arsimor/shkollor t'i edukojë të gjithë fëmijët dhe kështu pra ka nevojë që shkollat të ndryshojnë në mënyrë që të plotësojnë nevojat e ndryshme të të gjithë nxënësve. Transformimi kërkon modifikime në përmbajtje, qasje, struktura dhe strategji të përdorura në shkollë dhe në klasë. Menaxhmenti i shkollës duhet të jetë i përkushtuar ndaj transformimeve. Mësimdhënësit kanë një rol të rëndësishëm pasi që në shkollat gjithëpërfshirëse gjejnë mënyra për të njohur nxënësit e tyre, për të identifikuar nevojat e tyre të ndryshme, për të dalluar në mënyrë të përshtatshme kurrikulën dhe praktikën e vlerësimit dhe për të siguruar mbështetjen e duhur sipas të gjitha nevojave të nxënësve. Mësimdhënësit duhet të jenë të përgatitur mirë dhe të trajnuar për të menaxhuar një klasë gjithëpërfshirëse me nevoja të ndryshme.

Si pikënisje ka nevojë për një vizion të përbashkët për shkollën gjithëpërfshirëse. Rritja e vetëdijes dhe trajnimit për stafin e shkollës, prindërit dhe anëtarët e komunitetit është i nevojshëm për t'i bërë të gjithë të kuptojnë rëndësinë e edukimit për të gjithë. Elemente të tjera të nevojshme për zhvillim lidhen me identifikimin, qasjen në shkollë, ndryshimet në shkollë, qasjen në kurrikulë, ndryshimet në klasë, burimet dhe mbështetjen. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa elemente bazë për shkollën gjithëpërfshirëse, që përmban ide të theksuara nga projekti i binjakëzimit mbi atë se çfarë mund të bëjnë shkollat për të zhvilluar këto elemente.

AKTIVITETI 15

Çfarë mund të bëjë shkolla ime në zhvillimin e elementit të shkollës gjithëpërfshirëse?

Zhvillimi i një udhërrëfyese të shkollës për gjithëpërfshirje është detyrë individuale e secilit pjesëmarrës në këtë program trajnimit. Diskutoni tabelën më poshtë dhe hartoni një plan të veprimit për shkollën tuaj?



Tabela: Çka mund të bëjnë shkollat për t'i zhvilluar elementet që t'i bëjnë shkollat më gjithëpërfshirëse?

ÇKA NEVOJITET?	ÇFARË DUHET BËRË?
Vetëdijesimi	<p>Ndërgjegjësimi në shkollë dhe në komunitet lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> Të drejtat e të gjithë fëmijëve për arsim Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Ligjet dhe dokumentet e tjera që i përcaktojnë këto të drejta
Njohuritë	<ul style="list-style-type: none"> Parimet e arsimit gjithëpërfshirës Si të menaxhoni arsimin gjithëpërfshirës Drejtori i shkollës dhe mësimmshënësit marrin pjesë në trajnimet në shërbim Ndarja e informatave dhe organizime të trajnimeve për anëtarët e Këshillit Drejtues të Shkollave, prindërit dhe anëtarët e komunitetit
Zotimi	<ul style="list-style-type: none"> E gjithë shoqëria, komuniteti, shkolla, menaxhmenti, mësimmshënësit, prindërit duhet të jenë të zotuar.
Përfshirja e komunitetit	<ul style="list-style-type: none"> Anëtarët e komunitetit janë aktivë në zhvillimin dhe mbështetjen e shkollës Prindërit po mbështesin në mënyrë aktive zhvillimin e shkollës Grupet e pakicave marrin pjesë në zhvillimin e shkollës
Identifikimi	<ul style="list-style-type: none"> Anëtarët e komunitetit janë aktivë në zhvillimin dhe mbështetjen e shkollës Prindërit po mbështesin në mënyrë aktive zhvillimin e shkollës Grupet e pakicave marrin pjesë në zhvillimin e shkollës
Qasja në shkollë	<ul style="list-style-type: none"> Lehtësira për të gjithë fëmijët që të kenë qasje në shkollë; Sigurimi i qasjes fizike duke përfshirë shtigje anësore të pjerrëta, tualete të përshtatura dhe hapësira adekuate për karroca, klasat me fëmijë me nevoja të veçanta duhet të vendosen në dhomat e katin përdhës. Transporti ofrohet për ata në nevojë

<p>Ndryshime në shkollë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Sigurimi i qasjes fizike • Shërbimet mbështetëse në dispozicion • Dhoma burimore me mësimdhënës mbështetës • Zbatohen standardet për shkollën miqësore për fëmijët
<p>Qasja në kurrikulë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Qasja në mësimnxënie për të gjithë • Zbatimi i dallimeve të kurrikulës përfshirë përshtatjet e përmbajtjes, strategjitë e mësimdhënies, materialet dhe vlerësimin • Përdorimi i PIA-ve kur është e nevojshme.
<p>Ndryshime në klasë</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i një klase gjithëpërfshirëse • Klima në klasë: respekt, mirëkuptim, motivim dhe stimulim • Përkrahja e vetëbesimit pozitiv për të gjithë • Masat për mjedis optimal të mësimnxënies • Planifikimi dhe zbatimi i mësimin për t'i shërbyer nevojave të ndryshme (p.sh. stilet e mësimin, gjuha e përdorur, dallimet kulturore dhe gjinore në materiale) • Detyra optimale për të gjithë • Përgjigjet e pritshme për nxënësit, menaxhimi i kohës dhe transferet • Mbështetja në klasë • Menaxhimi i sjelljes në klasë • Diferencimet e përmbajtjes mësimore, strategjive, materialeve dhe praktikave të vlerësimit të të nxënit. • Metodatat e ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përdorim • Pajisje, furnizime, pajisje ndihmëse në dispozicion
<p>Burimet</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale në dispozicion në shkollë; • Raporti optimal mësimdhënës-nxënës • Mësimdhënës të kualifikuar • Mësimdhënës mbështetës • Ekipi mbështetës në shkollë është themeluar • Asistent i shkollës (me shpresë në të ardhmen) • Pajisje, furnizime, pajisje ndihmëse në dispozicion
<p>Mbështetje</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e brendshme: ekipi mbështetës, mësimdhënësit mbështetës, klubet e leximit, klubet e gjuhës, vullnetarët • Mbështetja e jashtme: mësimdhënësit lëvizës, ekipet komunale të vlerësimit, OJQ-të, anëtarët e komunitetit

12. Përmbyllja e Modullit

Ky modul kishte për synim të zhvillonte praktika gjithëpërfshirëse të arsimit në shkolla në mënyrë që të mbështeste përfshirjen e gamës së gjerë të preferencave dhe nevojave të të nxëniet që gjenden në klasat e sotme. Ai gjithashtu synonte t'i ekspozonte para pjesëmarrësve të dhënat dhe situatat e ndryshme ku u diskutuan aspektet e gjithëpërfshirjes së arsimit në Kosovë dhe qoi përpara më tej integrimin dhe përmirësimin.

Në të gjitha pjesët e këtij Moduli, synimi ishte të eksplorohehen dhe të diskutohen më tej disa nga praktikatat më të mira, problemet dhe sfidat në bërjen e arsimit gjithëpërfshirës realitet në shkollat e Kosovës. Aktivitete, diskutime dhe detyra të ndryshme kishin për qëllim të nxisnin diskutime ndërmjet pjesëmarrësve, si udhëheqës të arsimit. Ne i inkurajojmë të gjithë pjesëmarrësit që të vazhdojnë t'i ndajnë këto përvoja dhe njohuritë e fituara gjatë trajnimit në shkollat e tyre përkatëse. Për më tepër, ne shpresojmë që disa nga aktivitetet që nuk janë provuar gjatë trajnimit do të shërbejnë si pika fillestare për diskutime të mëtutjeshme në komunitetin tuaj shkollor. Materialet shtesë të leximit dhe shtojcat kanë për qëllim të nxisin zhvillimin tuaj profesional dhe personal, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikës së udhëheqjes.

✓ FJALORTHI

- **SHKOLLAT MIQËSORE PËR FËMIJËT** (ShMF) është qasja e UNICEF-it për të promovuar, mbështetur dhe zbatuar shkollat me fëmijët në qendër të vëmendjes, gjithëpërfshirëse, mbrojtëse dhe pjesëmarrëse. Ajo u quajt më parë si Shkollat Miqësore për Fëmijët.
- **KONVENTA MBI TË DREJTAT E FËMIJËS**, e miratuar në vitin 1989, është traktat ndërkombëtar që përcakton të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të të gjithë fëmijëve dhe ishte traktati i parë ndërkombëtar që theksonte se pikëpamjet e fëmijëve duhet të merren parasysh. Konventa elaboron kuptimin e së drejtës për arsimim në drejtim të universalitetit, pjesëmarrjes, respektit dhe gjithëpërfshirjes. Nenet 2, 23, 28 dhe 29 janë veçanërisht të rëndësishme për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- **DËMTIME** afatgjate fizike, mendore, intelektuale ose ndijore dhe pengesave të ndryshme në mjedis që mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të një personi në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët.
- **EDUKIMI PËR TË GJITHË** paraqet zotimin ndërkombëtar për të siguruar që çdo fëmijë dhe i rritur të kenë arsimim fillor të cilësisë së mirë. Ky zotim bazohet në këndvështrimin e të drejtave të njeriut dhe në besimin e përgjithshëm se arsimit është thelbësor për mirëqenien individuale dhe zhvillimin kombëtar. Lëvizja është lansuar në Konferencën Botërore mbi Edukimin për të Gjithë në vitin 1990 nga UNESCO, UNDP, UNICEF dhe Banka Botërore. Pjesëmarrësit miratuan një "vizion të zgjeruar të të nxëniet" dhe u zotuan për të universalizuar arsimin fillor

dhe për të ulur masivisht analfabetizmin deri në fund të dekadës. Një dekadë më vonë, për të ndihmuar qeveritë të përparonin drejt realizimit të EpGj-së, ata ranë dakord për gjashtë qëllimet e EpGj-së.

- **QASJA E BAZUAR NË TË DREJTAT E NJERIUT** është një kornizë konceptuale për përmbushjen e të drejtave të njeriut. Dy elementet kryesore të qasjes së bazuar në të drejta janë fuqizimi dhe përgjegjësia. Fuqizimi nënkupton pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara si akterë aktivë, ndërkohë që përgjegjësia lidhet me detyrën e institucioneve dhe strukturave publike për zbatimin e këtyre të drejtave dhe për arsyetimin e cilësisë dhe sasisë së zbatimit të tyre.
- **KLASIFIKIMI NDËRKOMBËTAR I FUNKSIONIMIT, AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE SHËNDETIT** koncepton nivelin e funksionimit të personit si një ndërveprim dinamik midis personit (me problem shëndetësor) dhe faktorëve kontekstual të atij personi (faktorët mjedisorë dhe faktorët personal). Ajo përcakton funksionalitetin dhe aftësinë e kufizuar si koncepte shumëdimensionale që lidhen me: funksionet e trupit dhe strukturat e njerëzve, aktivitetet që bëjnë njerëzit dhe fushat e jetës në të cilat ata marrin pjesë dhe faktorët në mjedisin e tyre që ndikojnë në këto përvoja.
- **GJITHËPËRFSHIRJA** është ajo ku ka njohje të nevojës për të transformuar kulturat, politikat dhe praktikën në shkollë për të akomoduar nevojat e ndryshme të nxënësve individual, dhe një detyrim për të hequr pengesat që pengojnë atë mundësi.
- **ARSIMI GJITHËPËRFSHIRËS** është “një proces i adresimit dhe reagimit ndaj diversitetit të nevojave të të gjithë nxënësve përmes rritjes së pjesëmarrjes në të nxënit, kultura dhe komunitete, dhe zvogëlimin të përjashtimit brenda arsimit dhe nga arsimit. Ai përfshin ndryshime dhe modifikime në përmbajtje, qasje, struktura dhe strategji, me një vizion të përbashkët që mbulon të gjithë fëmijët e moshës së duhur dhe një bindje se është përgjegjësi e shtetit t’i edukojë të gjithë fëmijët”.
- **INTEGRIMI** është vendi ku fëmijët me aftësi të kufizuara vendosen në klasa apo njësi të veçanta në shkollat e rregullta.
- **OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË MIJËVJEÇARIT**, si një zotim ndërkombëtar për të zvogëluar varfërinë, shihet si një pjesë e angazhimit më të gjerë për të “siguruar që deri në vitin 2015 fëmijët kudo, djemtë dhe vajzat, do të jenë në gjendje të përfundojnë një cikël të plotë të shkollimit fillor ose Arsimit Fillor Universal (AFU)”.
- **NDARJA (VEÇIMI)** në të cilin fëmijët me aftësi të kufizuara vendosen në shkolla speciale ose në njësi të veçanta brenda shkollave që janë të dizajnuara për t’iu përgjigjur dëmtimeve të tyre të veçanta ose aftësive të kufizuara;

BURIMET DHE REFERENCAT

- Arnold, C., Bartlett, K., Gowani, S., & Merali, R. (2006). A janë gati të gjithë? Gatishmëria, tranzicioni dhe vazhdimësia: Reflektimet dhe ecja përpara. Dokumenti i studimit për Raportin e Monitorimit Global të EpGj-s 2007
- Asociacioni i New England i Shkollave dhe Kolegjeve, Inc. Guidebook. (2009). Zhvillimi i vlerave, besimeve themelore dhe pritjeve mësimore. Komisioni për Shkollat e Mesme Publike.
- Bucholz, J. L. & Sheffler, J. (2009). Krijimi i mjedisit të ngrohtë dhe gjithëpërfshirës i klasës: Planifikimi që të gjithë fëmijët të ndjehen të mirëseardhur. Revista elektronike për arsimin gjithëpërfshirës 2(4).
- Devetaku-Gojani H. & Mehmeti S. 2014. Fëmijët jashtë shkollës në Kosovë. Studimi bazë mbi praktikën dhe përgjigjet ndaj braktisjes dhe mosvijimit në shkollë. Instituti Pedagogjik i Kosovës.
- European Agency for Special Needs and Inclusive Education. Profile of Inclusive Teachers. <https://www.european-agency.org/projects/te4i/profile-inclusive-teachers>
- Frumos, L. (2020). Inclusive Education in Remote Instruction with Universal Design for Learning, Revista Românească pentru Educație Multidimensională, 2020, Volume 12, Issue 2, Sup. 1,
- Guernsey, K., Nicoli, M. & Ninio, A. (2006). Bërja e Gjithëpërfshirjes Operacionale: Burimet ligjore dhe institucionale për stafin e Bankës Botërore për përfshirjen e çështjeve të aftësisë së kufizuar në projektet e investimeve. Marrë nga http://siteresources.worldbank.org/INT/LAË- JUSTICE/ Resources/LDËP1_Disability.pdf
- Komisioni Evropian. Edukimi dhe trajnimi për gjithëpërfshirjen sociale. http://ec.europa.eu/education/policy/strategic-framework/social-inclusion_en.htm
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës, neni 28 dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, neni 24
- Inclusive Schools. (2019). What Does an Inclusive Classroom Like? <https://inclusiveschools.org/what-does-an-inclusive-classroom-look-like/>
- MASH. Funkcionalizimi i Qendrave Burimore. <https://MASH.rks-gov.net/publikime-dhe-dokumente-per-femijetn-xenesit-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-me-veshtiresi-ne-te-nxene>
- MASH. 2017. Udhëzues për punën e mësuesit udhëtues. Prishtinë: MASH.
- MASH. 2019. Udhëzues për planifikim dhe raportim të punës së edukatoreve, mësuesve mbështetës si dhe asistentëve. Prishtinë: MASH
- Miller, R. & Pedro, J. (2006). Krijimi i mjedisve respektuese në klasa. Revista e arsimimit në fëmijërinë e hershme, 33(5).
- Misioni i OSBE-së në Kosovë. 2012d. Përcjellja e braktisjes së shkollës dhe mosvijimit në Kosovë. 2012. <http://www.osce.org/kosovo/95112?download=true>

- OECD. 2010. Edukimi i mësimdhënësve për diversitetin: Përmbushja e sfidës. <http://www.oecd.org/edu/ceri/44575633.pdf>
- OECD. 2010. Udhëzues për mësimdhënien e diversitetit <http://www.oecd.org/edu/ceri/toolkitonteachingfordiversity-encounteringandacknowledgingdiversityintheclassroom.htm>
- Partneriteti Global për Arsimin, <http://ëëë.globalpartnership.org/>
- Projekti i Binjakëzimit i BE-së. 2016. Udhërrëfyese për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen në arsimin parauniversitar në Kosovë. Raporti i pabotuar.
- Sistemi i Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) në <http://MASH-smia.net>
- Stubbs, S. (2008). Arsimi gjithëpërfshirës ku ka pak burime. Marrë nga <http://www.eenet.org.uk/resources/docs/IE%20feë%20resources%202008.pdf>
- The Atlas Alliance. Arsimi gjithëpërfshirës, ku ka burime të pakta. Nga Stubbs, redaktuar nga Ingrid Lewis, Versioni i azhurnuar 2008.
- Udhërrëfyese për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen për sistemin arsimor parauniversitar në Kosovë, <https://MASH.rks-gov.net/uploads/2018/05/udherrefyese-per-diversitetin-dhe-gjitheperfshirjen-ss-checked.pdf>
- UNESCO 2009. Udhëzimet e politikave për gjithëpërfshirjen në arsim. Paris: UNESCO
- UNESCO 1994. Deklarata Salamankës dhe korniza për veprim mbi arsimin me nevoja të veçanta. www.unesco.org/education/pdf/SALAMA_E.P
- UNICEF 2014. Studimi i Grupit të Treguesve të Shumëfishtë.
- UNFPA/WHO. (2009) Promovimi i shëndetit seksual dhe riprodhues për personat me aftësi të kufizuara: WHO/UNFPA guidance note. Geneva: WHO. http://whqlibdoc.who.int/publications/2009/9789241598682_eng.pdf
- Yale Pourvu Center for Teaching and Learning. Inclusive Classroom Climate. <https://poorvucenter.yale.edu/ClassClimates>
- Wessler, S. L. (2003). Shkolla respektuese. Si mund ta mposhtin mësimdhënësit dhe nxënësit urretjen dhe ngacmimin. Alexandria, VA: Asociacioni për Mbikëqyrjen e Zhvillimit të Kurrikulave.
- WHO & Banka Botërore. (2011). Raporti botëror për aftësinë e kufizuar. Marr nga http://www.who.int/disabilities/world_report/2011/en/index.html
- Zabeli, N. & Gjellaj, M. (2020). Creating inclusive cultures, policies and practice using the Index of inclusion – The Kosovo Case. *The International Journal of Diversity in Education*, 20 (1)
- Zabeli, N. dhe Behluli, L. (2014). Indeksi për gjithëpërfshirje – fakte dhe opinione. Prishtinë: Save the Children.

Shtojca 1.

Iniciativat kyçe ndërkombëtare që mbështesin arsimin gjithëpërfshirës për fëmijët me aftësi të kufizuara

- 1948:** Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- 1989:** Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës
- 1990:** Deklarata Botërore mbi Edukimin për të Gjithë (Deklarata e Jomtien)
- 1993:** Rregullat Standarde të OKB-së për Barazimin e Personave me Aftësi të Kufizuara
- 1994:** Deklarata e Salamankës dhe Korniza për Veprim në Arsim me Nevojat e Veçanta
- 2000:** Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (të vendosura për t'u arritur deri në vitin 2015)
- 2000:** Forumi Botëror i Arsimit për Veprim, Dakar
(riphoi nevojën urgjente për t'u shtrirë tek grupet e marginalizuara)
- 2001:** Synimi i EpGj-së mbi të Drejtën e Arsimit për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara:
Drejt gjithëpërfshirjes
- 2006:** Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- 2014:** Negociatat e kornizës zhvillimore pas vitit 2015 (Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm)
me një fokus në edukimin gjithëpërfshirës cilësor, janë në progres e sipër

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e miratuar në vitin 1989, është një traktat ndërkombëtar që përcakton të drejtat civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të të gjithë fëmijëve dhe ishte traktati i parë ndërkombëtar që theksonte se pikëpamjet e fëmijëve duhet të merren parasysh. Konventa elaboron kuptimin e së drejtës për arsim në drejtim të universalitetit, pjesëmarrjes, respektit, dhe gjithëpërfshirjes. Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, e miratuar në vitin 2007, përforcon dhe zgjeron më tej konceptin e së drejtës për arsim, dhe ka futur detyrime shtesë ndaj qeverive për të siguruar realizimin e tyre. KDF thekson nevojën që qeveritë të sigurojnë qasje të barabartë në një “sistem arsimor gjithëpërfshirës në të gjitha nivelet” dhe të ofrojnë mbulim të arsyeshëm dhe shërbime mbështetëse individuale për personat me aftësi të kufizuara për të lehtësuar arsimimin e tyre.

NË NENIN 24 TË KDPAK (CRPD) PËRFSHIHET SI NË VIJIM:

- Personat me aftësi të kufizuara nuk guxojnë të përjashtohen nga sistemi i arsimit të përgjithshëm në bazë të aftësisë së kufizuar, dhe se fëmijët me aftësi të kufizuara nuk guxojnë të përjashtohen nga arsimi fillor pa pagesë dhe i detyrueshëm, ose nga arsimi i mesëm në bazë të aftësisë së kufizuar;
- Personat me aftësi të kufizuara mund të kenë qasje në arsimin fillor dhe në arsimin e mesëm gjithëpërfshirës, cilësor dhe pa pagesë, në baza të barabarta me të tjerët në komunitetet në të cilat jetojnë;
- Duhet të sigurohet mbulimi i arsyeshëm i kërkesave të personit;
- Personat me aftësi të kufizuara duhet të marrin mbështetjen e kërkuar brenda sistemit të arsimit të përgjithshëm, për të lehtësuar arsimimin e tyre efektiv;
- Masat efektive të mbështetjes individuale ofrohen në mjedise që maksimizojnë zhvillimin akademik dhe social, në përputhje me synimin e përfshirjes së plotë.

Zhvillimi i Arsimit Gjithëpërfshirës

Në vitin 1994, Konferenca Botërore për Arsim me Nevoja të Veçanta në Salamanka të Spanjës nxori një deklaratë dhe kornizë për veprim. Deklarata e Salamankës dhe Korniza për Veprim u nënshkruan nga 92 vendet pjesëmarrëse, dhe disa kanë thënë se është dokumenti më me ndikim në kohët e fundit në arsimin gjithëpërfshirës (Ainscoë 1999). Deklarata e Salamankës inkurajoi qeveritë të zhvillojnë sisteme arsimore që i përgjigjen nevojave të ndryshme në mënyrë që të gjithë nxënësit të kenë qasje në shkollat e rregullta që i akomodojnë ato në pedagogji me fëmijën në qendër të vëmendjes. Deklarata ka një fokus të fortë në ‘zhvillimin e shkollave gjithëpërfshirëse’ në lidhje me synimin ndërkombëtar të arritjes së Edukimit për të Gjithë.

Edukimi për të Gjithë

EpGj-ja përfaqëson zotimin ndërkombëtar për të siguruar që çdo fëmijë dhe i rritur të kenë arsimim fillor të cilësisë së mirë. Ky zotim bazohet në këndvështrimin e të drejtave të njeriut dhe në besimin e përgjithshëm se arsimi është thelbësor për mirëqenien individuale dhe zhvillimin kombëtar. Lëvizja u lansua në Konferencën Botërore mbi Arsimin për të Gjithë në vitin 1990 nga UNESCO, UNDP, UNICEF dhe Banka Botërore. Pjesëmarrësit miratuan një “vizion të zgjeruar të të nxëniet” dhe u zotuan për të universalizuar arsimin fillor dhe për të ulur masivisht analfabetizmin deri në fund të dekadës. Një dekadë më vonë, për të ndihmuar qeveritë të përparonin drejt realizimit të EpGj-së, ata ranë dakord për gjashtë synimet e EpGj-së.

Gjashtë Synimet e EpGj-së përfshijnë:

SYNIMI 1

Zgjerimi dhe përmirësimi i kujdesit gjithëpërfshirës dhe edukimit në fëmijërinë e hershme, veçanërisht për fëmijët më të prekshëm dhe të disfavorshëm.

SYNIMI 2

Të sigurohet që deri në vitin 2015 të gjithë fëmijët, veçanërisht vajzat, fëmijët në rrethana të vështira dhe ata që i përkasin pakicave etnike, të kenë qasje në arsimin fillor pa pagesë dhe të detyrueshëm me cilësi të mirë.

SYNIMI 3

Të sigurohet se nevojat e të mësuarit për të gjithë të rinjtë dhe të rriturit të përmbushen përmes qasjes së barabartë në programet e duhura të mësimi dhe aftësive për jetë.

SYNIMI 4

Arritja e një përmirësimi prej 50 për qind në nivelet e shkrim-leximit të të rriturve deri në vitin 2015, veçanërisht për gratë, dhe qasjes së barabartë në arsimin fillor dhe të vazhdueshëm për të gjithë të rriturit.

SYNIMI 5

Eliminimi i pabarazive gjinore në arsimin fillor dhe të mesëm deri në vitin 2005, dhe arritja e barazisë gjinore në arsim deri në vitin 2015, me fokus në sigurimin e qasjes së plotë dhe të barabartë të vajzave në arritjen e arsimit fillor të cilësisë së mirë.

SYNIMI 6

Përmirësimi i të gjitha aspekteve të cilësisë së arsimit dhe sigurimi i përsosmërisë së të gjithëve, në mënyrë që rezultatet e të mësuarit të njohura dhe të matshme të arrihen nga të gjithë, sidomos në shkrim-lexim, shkathësitë e operimit me numra, dhe shkathësitë themelore të jetës.

